



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Mjekësi Bimore”**

**i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Valbona Sota

2. Prof. Asoc. Arben Mehmeti

Korrik, 2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përbledhës

Programi Master i Shkencave në "Mjekësi Bimore", ofrohet për studentët nga Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ky program studimi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 538, datë 08.11.2012 pasi i është nënshtruar procesit të vlerësimit për hapje, nga Agjencia Publike e Akreditimit në Arsimin e Lartë (sot ASCAL) në vitin 2012. Me Vendimin Nr. 382, datë 26.10.2012, Këshilli i Akreditimit në vitin 2012 ka rekomanduar hapjen e Programit Master i Shkencave në "Mjekësi Bimore" me disa sugjerime.

Programi i studimit Master i Shkencave në 'Mjekësi Bimore', me një shtrirje 2-vjeçare dhe me 120 ECTS në total, është rezultat projektit të Tempus të BE-së duke filluar që nga viti 2010 për të krijuar një "Diplomë Master të Përbashkët Ndërkombëtare në Mjekësinë e Bimëve". Pjesëmarrës të projektit janë Universitetet e Barit në Itali (Udhëheqësi i Projektit), Plovdiv në Bullgari dhe Athina në Greqi. Universitetet partnerë të Evropës Juglindore ishin Tirana dhe Korça në Shqipëri, Universiteti i Prishtinës në Kosovë, Osijek dhe Zagreb në Kroaci, Beograd dhe Novi Sad në Serbi, Shkup dhe Tetovë në Maqedoni.

Programi aktual Master i Shkencave në 'Mjekësi Bimore' mund të gjenerojë ekspertët e nevojshëm në fushën e Mjekësisë bimore dhe prandaj është me rëndësi, por gjithmonë duke analizuar nevojat e tregut për specialistë të fushës së Mjekësisë bimore.

Një përparësi e madhe e projektit Tempus është që të gjitha universitetet partnerë ofrojnë leksione të përbashkëta në bazë të materialit mësimor aktual. Megjithatë, shkenca po ndryshon me ritëm të shpejtë dhe nevoja për hulumtime në fushën e shkencave molekulare është e nevojshme. Prandaj, në të ardhmen duhet fokusuar në përgatitjen e kuadrit të ri dhe sigurimin e pajisjeve në shkenca molekulare për të gjitha fushat e Mjekësisë bimore.

Vlerësimi i studimeve të reja master në Mjekësi bimore në UBT duhet të bazohet kryesisht në nevojat e Republikës së Shqipërisë bazuar në një standard të lartë ndërkombëtar siç kërkohet për zhvillimin e ardhshëm të vendit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit "Master i shkencave" në "Mjekësi Bimore", zhvillohet pas fazës së aplikimit dhe fazës së vlerësimit të brendshëm dhe dorëzimit të Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) nga Institucioni.

Ky proces filloj me përcaktimin nga ASCAL dhe BA, të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ, të përbërë nga Ekspertë të fushës). GVJ dakordësoi agjendën e detauar të vizitave në Institucion, zhvilluar në datat 30 dhe 31 Mai 2019.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dyte "Master i shkencave" në "Mjekësi Bimore", ofruar nga UBT. Në hartimin e këtij Raporti, GVJ është mbështetur nga dokumentacioni i DVV-së të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVR).

Gjatë vizitave në institucion, ekspertët e jashtëm kërkuajn informacione të tjera shtesë sipas nevojave të cilat institucioni i vuri menjëherë në dispozicion të tyre. Gjatë fazës së vizitave, ekspertët e jashtëm u takuan me përfaqësuesit e stafit, studentëve dhe palët e tjera të interesit të institucionit të arsimit të lartë. Qëllimi i vizitës dy ditore ishte shqyrtimi i të dhënavës dhe informacioneve, ballafaqimi me infrastrukturën në dispozicion të këtij program studimi etj. Të gjithë elementët e analizuar gjatë vizitës ishin të domosdoshëm për të përpiluar në mënyrë të plotë dhe korrekte RVI-në.

Gjatë procedurës së vlerësimit, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Zni. Emisa Isufaj.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 44/44 Prot., datë 15.07.2019. UBT përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 248 Prot., datë 23.07.2019 komentet për draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të jepin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë një reflektim si më poshtë:

GVJ shqyrttoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe shqyrttoi evidencat e reja të sjella nga IAL. Ky dokumentacion shtesë u mor në konsideratë dhe u reflektouan ndryshimet përkatëse në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Lidhur me komentete IAL mbi draft-raportin të paraqitura sipas fushave, sqarimi i grupit të ekspertëve të jashtëm është si vijon:

Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV. 2, Kriteri 3**, edhe nga vetë Grupi Vlerësimit të Brendshëm konstatohet se sistemi I-Learning përmirësohet në këtë rast, por nuk ka ndryshme përgjithësisht. Pra, ky koment i tyre është në përpunje me atë që thuhet në draft-raport. Nuk ka ndryshme përgjithësisht.

Lidhur me komentin që bëhet për Standardin IV. 2, Kriteri 1, theksojmë se Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka konstatuar se mjediset sa nuk janë të mjaftueshme për numrin e studenteve, mirëpo për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ka konstatuar se disa mjedise (me theks të veçantë infrastruktura e laboratorit në Shkozet duhet rinnovuar). Për këtë arsy, shtohet në raport *me theks të veçantë laboratori në Shkozet....* ndërsa pjesa tjetër e komentit qëndron e pandryshuar.

Lidhur me Standardin IV. 6, Kriteri 2, Grupi Vlerësimit të Brendshëm vetëm ka cituar atë që është shkruar në draft-raport, por nuk ka dhënë përgjigje konkrete. Nuk ka ndryshme në Raport lidhur me këtë koment.

Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV. 3, Kriteri 3 dhe 4**, Grupi Vlerësimit të Brendshëm ka siguruar marrëveshjet e kërkura nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe i kvënë në dispozicion ato. Këto dokumente janë marrë në konsideratë nga GVJ dhe paragrafi i fundit në **Standardin IV. 3, Kriteri 5 riformulohet si vijon**: ‘GVJ konstaton se ekzistojnë 2 dokumente të marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni me të tilla kompani apo biznese (**dok. Msc.1 dhe Msc.2 – Marrëveshjet e bashkëpunimit - nga komentet e IAL**). Shtimi i të tillë marrëveshjeve me nënshkrim të dyanshëm janë domosdoshmëri për konsolidimin e bashkëpunimit dhe janë tregues serioziteti në këtë angazhim’.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë
Master i Shkencave në "Mjekësi Bimore"

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit të depozituar (dok. DVV nr.7: Rregullore e programit të studimit, Neni 5) vlerësohet se programi i studimit Master i Shkencave në "Mjekësi Bimore" nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por i mbështet plotësisht ato në drejtim të evidentimit të problematikave madhore dhe zgjidhjen e tyre nëpërmjet kurimit të patologjive të ndryshme bimore dhe elementë të lidhur, çështje që në çdo gjeneratë janë domosdoshmëri e kohës.
Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, por dhe nga informacioni i vënë në dispozicion (dok. DVV nr. 2: Statuti i UBT-së, Kru VII, Neni 49 dhe nr. 3: Strategjia e institucionit 2016-2025), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se ky program studimi synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. GVJ konstaton se një element shumë i rëndësishëm që i rrit vlerat është fakti se ky program është rezultat i një projekti të rëndësishëm të financuar nga BE (Tempus) për të krijuar një "Diplomë Master të Përbashkët (Joint Master Program)" me 12 universitete të huaja (dok. DVV nr. 58: Cooperation Agreement TEMPUS IPM). Kësisoj, GVJ thekson se këto vlera akademike e kulturore kombëtare ky program studimi i evidenton fuqishëm edhe në arenën ndërkontinentale.
Kriteri 3. Programi i studimit hartoher dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimitarës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit në këtë fushë (Statuti i UBT-së – dok. DVV Nr. 2; Plani strategjik i UBT-së 2016-2025 – dok. DVV nr. 3). Veç të tjerash konstatohet se programi Master i shkencave në "Mjekësi Bimore" është në harmoni të plotë me programin e ciklit të parë në "Inxhinieri Agrare, Profili: Mbrotjtë Bimësh".
Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave" hartoher dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Vlerësohet se ky program përkon me strategjitet e aplikuara për zhvillimin ekonomik të vendit dhe merr parasysh dhe problematikat kombëtare në fushën e studimit në fjalë. Ajo që vlen të theksohet është se, për përgatitjen e specialistëve të këtij profili dhe për zgjidhjen e problematikave specifike kombëtare në drejtim të mbrojtjes së bimëve, ky është ndër programet e pakta që aplikohen në nivel kombëtar dhe i vetmi që ka këtë traditë dhe

	konsolidim disavjeçar.						
Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Ky program përbush jo vetëm qëllimin kryesor për përgatitjen e specialistëve të fushës, por edhe atë për kërkim shkencor më të avancuar. GVJ thekson se, meqë ky program është rezultat i një projekti të rëndësishëm të finançuar nga BE (Tempus) për të kriuar një "Diplomë Master të Përbashkët (Joint Master Program)" me 12 universitete të huaja, kriohen mundësi për vazhdimësi tepër efektive në programet e ciklit të tretë, si brenda ashtu dhe jashtë vendit (dok. DVV nr. 58: Cooperation Agreement TEMPUS IPM).						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesish</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td></tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesish	Përbushjet plotësisht			X
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesish	Përbushjet plotësisht					
		X					

Standardi I.2

Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohej dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjitet e institucionit të cilat janë të fokusuara në dy drejtime kryesore: <i>mësimdhënia</i> dhe <i>kërkimi shkencor</i> duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të institucionit në të dy komponentët e lartpërmendur (dok. DVV nr. 3: Strategjia e institucionit 2016-2025). Kjo evidentohet qartë jo vetëm nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe gjatë intervistave me personelin akademik, të cilët punojnë për forcimin e këtyre dy shtyllave kryesore të strategjisë. <i>GVJ thekson se duhet synuar më shumë për kërkime shkencore, pasi, duke u bazuar në numrin e orëve në të cilat pedagogët janë të angazhuar, rezulton se për momentin mësimdhënia është primare. Kjo gjë reflektohet qartë në dokumentin e ngarkesës mësimore (dok. DVV nr.6: Planifikimi i ngarkesës 2018-2019 - nga vizita në institucion).</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohej dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga GVJ konstatohet se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) dhe Departamenti i Mbrotjtës së Bimëve (DMB), që kanë në përgjegjësi realizimin e këtij programi studimi, koordinojnë me efikasitet progresin e tyre me Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit (dok. DVV nr. 4: Strategjia e institucionit 2016-2025) dhe me rregulloret specifike të tyre (dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM dhe Rregullore e DMB).
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Nga GVJ konstatohet se DMB funksionon në harmoni të plotë me strategjitet e FBM-së dhe kësisoj programi i studimit Master i Shkencave "Mjekësi Bimore", në tërë komponentët e tij, vlerësohet se ofrohet plotësisht në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit (dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM dhe Rregullore e DMB).



Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjite kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	GVJ thekson se ky program studimi është në harmoni me trendet globale të zhvillimit në bujqësi, problematikave si pasojë e shfaqjes së patologjive bimore dhe gjetjes së zgjidhjeve për elemenimin e tyre, elementë që përforcohen nga fakti i projektit të përbashkët me 12 universitete të huaja (dok. DVV nr. 58: Cooperation Agreement TEMPUS IPM).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi I.3

Programi i studimit "Master i shkencave" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit "Master i shkencave" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njojuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin, por edhe nga intervistat gjatë ditëve të vizitës rezulton se në programin e studimit pëershruhen qartë objektivat e mësimdhënies, dhe se ky program realizohet në përputhje me këto objektiva (dok. DVV nr. 7: Rregullore e programit të studimit dhe nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB).</p> <p>Konstatohet se qëllimi dhe objektivat specifikë të programit të studimit, janë të përcaktuar në Nenin 6, të Rregullores së tij.</p> <p>GVJ konstaton se këto objektiva janë në unison me ato të programeve të ngjashme në 12 universitete të huaja. Në fokusin kryesor është përcjellja e njojurive të reja nëpërmjet mësimdhënies dhe standardeve të larta profesionale.</p> <p>Në lidhje me formimin e studentëve synohet pajisja e tyre me njojuritë që çojnë drejt studimeve të thelluara të ciklit të tretë (dok. DVV nr. 7: Rregullore e programit të studimit dhe nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB, Neni 5 dhe 6).</p>
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombeatar të punës për programin e studimit që ofron përpresa hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitet e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	<p>Nga grumbullimi dhe vlerësimi i informacionit nga GVJ, rezulton se programi i studimit është hartuar deri diku në përputhje me nevojat e tregut të punës. GVJ thekson faktin se, si program ndoshta unikal në nivel kombëtar, tregu i punës ka nevojë të madhe për specialistë të diagnostikimit dhe kurimit të patologjive bimore.</p> <p>Tabela përbledhëse për punësimin real të studentëve (dok. DVV nr. 17: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve) flet në mënyrë të përgjithshme mbi punësimin e studentëve në nivel fakulteti ose më gjerë, ndërsa dok. DVV nr. 17: Studentët paraqet punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi dhe vërehet se numri i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën është relativisht i ulët (2/10).</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, zhvillonte pyetësorë on-line me studentë të diplomuar (alumni) për të evidentuar:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> - përputhshmérinë e pozicionit të punës me përputhshmérinë e studimeve; - kënaqshmérinë/dobishmérinë e studimeve për pozicionin e punës që ushtrojnë (për studentët e punësuar në profilin e studimeve) - sugjerime për përmirësimë të mëtejshme në programet e studimit në mënyrë që ato t'i përgjigjen nevojave dhe kërkësave të tregut të punës. <p><i>Gjatë intervistave nga përfaqësues të Qendrës së Karrierës Alumni (QKA) theksohet se vërehet një indiferencë nga ana e studentëve të diplomuar për plotësimin e formularit on-line në lidhje me punësimin.</i></p>
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit garantojnë përfstimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>GVJ konstaton se FBM në përgjithësi dhe DBM në veçanti gjëzon një eksperiencë shumënjecare dhe përbëhet nga një staf mjaft i kualifikuar, gjë që mundëson optimizimin e programit të studimit në detaje specifike të mësimdhënies, transmetimit të dijeve, realizimit të objektivave etj. GVJ thekson se diçka e tillë garanton diplomimin e specialistëve me formim të thelluar teorik dhe veçanërisht praktik, domosdoshmëri e kohës për vendin tonë. Theksohet se këta janë elementë të domosdoshëm përritjen e mundësive të punësimit.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në 2 vite akademike / 4 semsetra. Çdo semester zhvillohen 5 lënde, kurse semestri i fundit është i dedikuar për përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së diplomimit.</p> <p>Përbledhja dhe rezultatet e të nxënësit janë të përshkruara në syllabuset e lëndeve / moduleve përkatëse.</p> <p>Nga shqyrtimi i kurrikulës mësimore (dok. DVV nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB) rezulton se struktura dhe përbajtja e programit të studimit (dok DVV nr. 19: Syllabuset e lëndëve), i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>
Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<p>GVJ konstaton se ky është një program studimi me kurrikula të harmonizuara me 12 universitete të huaja (dok. DVV nr. 58: Cooperation Agreement TEMPUS IPM). Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, në kuadër të projektit TEMPUS, u finalizua hartimi dhe zhvillimi i Masterit të përbashkët ndërkombëtar në Mjekësinë Bimore (IPM) në kurrikulat e Fakulteteve të Bujqësisë në Universitetet e Tiranës dhe Korçës (Shqipëri), Osijek dhe Zagreb (Kroaci), Prishtinë (Kosovë), Shkup dhe Tetovë (Maqedoni), Beograd dhe Novi Sad (Serbi), universitete të cilat u mbështetën dhe integruan me Universitetet e Plovdivit (Bullgari), Athinës (Greqisë) dhe Bari (Itali).</p>
Kriteri 5. Programi i studimit hartohej në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	<p>GVJ konstaton se ky program studimi është planifikuar, zhvilluar dhe organizuar nga Grupi Didaktik i Punës (DWG) së projektit TEMPUS me 12 universitete të huaja, (dok. DVV nr. 58: Cooperation Agreement TEMPUS IPM), dhe, si rrjedhim, rezulton të jetë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>




<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave" përfshin aftesimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombe të përfshirët përfshirët profesional e rregulluara.</p>	<p>Nga vlerësimi rezulton se ky është një program studimi, me qëndrueshmëri, traditë dhe vazhdimësi disavjeçare, dhe si i tillë është unik në nivel kombëtar përsa i përket cilësive të lartpërmendura. Në lidhje me sa më sipër rezulton se ky program garanton plotësisht formimin teorik dhe praktik të specialistëve me aftesi të larta në fushën përkatëse, një domosdoshmëri themelore e tregut në ditët e sotme (dok. DVV nr. 7: Rregullore e programit të studimit dhe nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB).</p>						
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit "Master i shkencave" duhet të përfshihen elemente të mësimdhënieς, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombe tarizimin e institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit), dhe gjatë intervistave me personelin akademik, GVJ konstaton se ata kanë realizuar mobilitetë të shumta në kuadër të programit TEMPUS, me qëllim trainimin dhe fitimin e aftësive të reja për mësimdhënie në gjuhë të huaj. GVJ ka konstatuar se DMB ka organizuar një semestër me pesë lëndë në Gjuhen Angleze (dok. DVV nr. 75: Lista e moduleve që do të zhvillohen në gjuhën angleze).</p>						
<p>Kriteri 8. Për programin studimit "Master i shkencave" institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Në kuadër të sa më sipër, GVJ konstaton se, për të qenë në standarde ndërkombe, dokumentacioni (syllabuse, kurrikula, leksione, etj.) shpërndahen dhe në gjuhën angleze dhe janë lehtësish të aksesueshme në website-in:</p> <p>http://tempus.agrif.bg.ac.rs/repository/5.Training-Working-Group/</p>						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><input checked="" type="checkbox"/></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			<input checked="" type="checkbox"/>
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
		<input checked="" type="checkbox"/>					

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion nga GVJ konstatohet se ekzistonjë të gjitha kapacitetet si në infrastrukturë, burime njerëzore, përvojë akademike, ashtu dhe struktura ndihmëse universitare mjaft efektive, gjë që rrit efektivitetin e ofrimit të këtij program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik (14 anëtarë gjithsej nga të cilët 10 anëtarë rezultojnë të profilit mësimor - kërkimor dhe 4 anëtarë rezultojnë të profilit kërkimor - mësimor) (dok. DVV nr. 23: Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit) është i kualifikuar, me një përvojë shumëveçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënieς dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Rezulton se i gjithë stafi i brendshëm ka kualifikime të thelluara në drejtimet specifike që mbulon ky program studimi (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit), gjë që</p>



	<p>garanton ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe përgatitjen e specialistëve të fushës.</p> <p><i>Sugjerohet që në vijim të punësimeve të reja të shihet mundësia e rekrutimit të personelit të ri në moshë në mënyrë që të krijohet një lidhje dhe vazhdimësi midis brezave të ndryshëm.</i></p> <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th><th>Përbushjet kryesisht</th><th>Përbushjet plotësisht</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td></tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
		X					

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënien bashkëpunimi me institucionë, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënien të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marres së	<p>Nga vlerësimi rezulton se DMB menaxhon dhe drejton me efektivitet këtë program studimi i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përbman 120 kredite.</p> <p>Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (ZSS, QKA, Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë etj.) në mënyrë që të lehtësohet i gjithë aktiviteti i studentëve brenda institucionit gjatë të gjitha viteve të studimit dhe të rritet efektiviteti i këtij programi</p>



<p>përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>studimi.</p> <p>Është mëse e qartë se edhe brenda DMB, i gjithë stafi akademik dhe ndihmës/akademik përbush me përpikmëri detyrimet profesionale dhe detyrat e caktuara në dobi të rritjes së cilësisë së këtij programi studimi.</p> <p>Për të vlerësuar performancën dhe arritjen e objektivave të programit të studimit, institucioni kryen analiza periodike/vjetore në nivel fakulteti, departamenti dhe për njësi të tjera të sigurimit të cilësisë (dok DVV nr. 37: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë dhe nr. 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxenit dhe aftësimit profesional)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesional.</p>	<p>GVJ konstaton, se si rrjedhojë e faktit që ky program studimi është krijuar nga projekti TEMPUS, ka një marrëveshje bashkëpunimi për njohje reciproke të diplomave me 12 universitete (dok. DVV nr. 34: Consortium Agreement, Bari - Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesional). GVJ thekson se kjo paraqet një rëndësi të madhe për shkëmbimin e eksperiencave me qëllim realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, etj.</p> <p>Një rol mjaft të rëndësishëm që rrit kapacitetet e mësimdhënieve, të kërkimit shkencor si dhe të kualifikimeve të vazhdueshme të stafit akademik dhe studentëve është dhe përfshirja në projekte të rëndësishme ndërkombëtare si: ERASMUS PLUS dhe CEEPUS (dok. DVV nr. 34: Consortium Agreement, Bari; dok. DVV nr. 34: Agricultural University of Tirana Antoniou).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit "Master i shkencave", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucionet, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se janë të listuara një sërë biznesesh dhe/ose institucionesh të sektorit publik apo privat (dok. DVV nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesional), nëpërmjet të cilëve institucioni u mundëson studentëve realizimin e praktikave profesionale. GVJ thekson se kjo gjë që paraqet një rëndësi të madhe për shkëmbimin e eksperiencave, lidhjes me tregun e punës, rritjes së mundësisë për punësim, kualifikimeve të mëtejshme të studentëve nëpërmjet praktikave profesionale etj.</p> <p>GVJ konstaton se ekzistojnë 2 dokumente të marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni me të tilla kompani apo biznese (dok. Msc.1 dhe Msc.2 – Marrëveshjet e bashkëpunimit - nga komentet e IAL). Shtimi i të tillë marrëveshjeve me nënshkrim të dyanshëm janë domosdoshmëri për konsolidimin e bashkëpunimit dhe janë tregues serioziteti në këtë angazhim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Konstatohet se gjatë dy viteve të studimit në këtë program studentët realizojnë praktikat në institucione të sektorit privat me të cilat institucioni ka kryer marrëveshje paraprake (dok. DVV nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda</p>

praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale). Rezulton se numri i studentëve që marrin pjesë në këto praktika mësimore është i lartë dhe dok Msc. 4.1 - Grafiku mbi praktikat mësimore – nga komentet e IAL , evidenton mbikëqyrjen nga personeli akademik të frekuentimit të rregullt të ditëve të praktikës, efektivitetin e tyre etj.
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Vlen për t'u theksuar numri i mobiliteteve në kuadër të programit ERASMUS, faktor i rëndësishëm për ruajtjen e lidhjeve me institucione të ngashme në arenën ndërkombëtare dhe tregues i qartë i koherencës midis programeve të studimit gjë që evidentohet nëpërmjet ekuivalentimit të lëndëve (dok. DVV nr. 34: Agricultural University of Tirana_Antoniou).
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Gjatë intervistave me stafin e DMB, por edhe nga shqyrtimi i RVB pretendohet se njësia përgjegjëse për këtë program studimi harton periodikisht raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, <i>por kjo nuk dokumentohet qartë</i> . Ajo që rezulton plotësisht e dokumentuar dhe e realizuar me efektivitet është 'shërbimi për të tretë' që DMB realizon nëpërmjet dy laboratorëve kombëtarë të referencës në drejtim të diagnostikës së patologjive bimore dhe certifikimit të materialit bimor.
Shkalla e përbushjes së standartit	Përbushjet pjesërisht Përbushjet kryesisht Përbushjet plotësisht <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> X

Standardi I.6	Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>GVJ konstaton se në statutin e institucionit (dok. DVV nr. 2: Statuti i UBT-së) dhe në rregulloret e niveleve të ndryshme rezulton e shprehur mjaft qartë se dy shtyllat themelore në të cilën insitucioni investon, monitoron dhe kërkon cilësi maksimale janë <i>mësimdhënia</i> dhe <i>kërkimi shkencor</i>.</p> <p>Konstatohet nga GVJ, por edhe pohohet nga vetë personeli akademik se institucioni inkurajon në mënyrë të vazhdueshme aplikimin në projekte shkencore, lehtëson procedurat e mobilitetit të stafit akademik dhe aktualisht është partner në shumë projekte ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë intervistave me personelin akademik, ata shprehen se institucioni nuk mbështet financiarisht botimet apo prezantimet në revista apo konferenca ndërkombëtare. Ata shprehen që do të dëshironin që të gjendej një mundësi financimi, pas një vlerësimi</p>

	<i>paraprak shkencor të punimit shkencor që do të botohet.</i>
Kriteri 2. Institucioni ngrë një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se detyrim i DMB është përpilimi dhe prezantimi i analizës kërkimore vjetore ku nxirret në pah performanca individuale e personelit akademik në drejtim të përfshirjes në projekte, numrit të botimeve etj. por edhe evidentohen problematikat dhe diskutohet për zgjidhjen e tyre. Kjo analizë vjetore i bashkangjitet asaj të institucionit (dok. DVV nr. 38: Analiza e Punës Kërkimore 2018).
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Gjatë intervistave me personelin akademik ata pohojnë se në mënyrë periodike institucioni bën publike rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. E dokumentuar kjo shprehet mjaft qartë në Raport Analizën e Punës Kërkimore UBT 2017 – 2018 (dok. DVV nr. 37: Analiza e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike).
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Gjatë intervistave me personelin akademik ata pohojnë se Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në përputhje me kriteret që përcaktohen nga ligji dhe kodi i etikës.
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Nga intervistat me studentët konfirmohet se institucioni krijon mundësinë e mobiliteteve, lehtëson procedurat për realizimin e tyre, inkurajon dhe mundohet të krijojë kushte të mira për kërkim të thelluar shkencor jo vetëm në laboratoret e DMB, por edhe në institucione të huaja nëpërmjet partneritetit në projekte shkencore.
Shkalla e përbushjes së standartit	Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit	Gjatë procedurës së vlerësimit GVJ konstaton se DBM është i organizuar në dy grupe mësimore, përkatesisht Entomologji dhe Fitopatologji. Anëtarët e njësisë bazë janë të angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin e syllabuseve dhe në realizimin e këtij programi studimi (dok. DVV nr. 19: Syllabuset e lëndëve).



<p>Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Rezulton se ky program studimi është i organizuar në module, të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh dhe në total 120 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjërë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kurrikulës (dok. DVV nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB) dhe objektivave formues rezulton se ky program studimi ofron njojuri dhe kompetenca bazë të domosdoshme për vijimin e studimeve të ciklit III dhe është i harmonizuar mjaft mirë me programin e ciklit të parë të DMB. Rezulton se programi është i fokusuar mjaft qartë në drejtimet e veçanta të fitopatologjisë, entomologjisë, menaxhimit të integruar të parazitëve, kontrollit biologjik, përdorimit të qëndrueshëm të pesticideve, laboratoreve diagnostikues me metoda inovative, etj., drejtime këto që ofrojnë mundësi të shumta të krijimit të shprehive dhe përfshimit të njojurive të thelluara në një shumëllojshmëri specialitetesh që kanë të bëjnë me diagnostikimin e patologjive bimore dhe kurimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave” jep njojuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor (dok. DVV nr. 1: Plani mësimor nga vizita në institucion), syllabuseve (dok. DVV nr. 19: Syllabuset e lëndëve) etj. por nga intervistat me personelin akademik dhe studentët, del në pah fakti që ky program studimi jo vetëm synon thellimin teorik dhe aftësimin praktik në drejtime specifike të lidhura me objektivat formues, por krijon mundësi të mëdha për përparimin akademik të mëtejshëm, të cilat ndjekin linjën e universiteteve ndërkombëtare me të cilat ky program është i njehsuar.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” zhvillon njojuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ thekson se ky program studimi, si program unikal në nivel kombëtar, është i një rëndësie tepër të lartë me detyrën kryesore atë të krijimit të specialistëve të fushës. Në kohët e sotme çështjet që kanë të bëjnë me patologjitetë bimore, kurimin e tyre, përdorimin e pesticideve etj. janë ndër diskutimet më të nxerhta në mbarë opinionin publik dhe kanë impaktin e drejtperdrejtë në shëndetin e popullatës. Në lidhje me sa më lart, GVJ konstaton se detyra themelore e këtij programi studimi që është përgatitja e specialistëve me përgatitje të thellë teorike dhe aftësi të larta praktike, përbushjet mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në dok. DVV nr. 6: Rregullore e DMB dok.; dok. DVV nr. 6: Rregullore e MSHMB; dok. DVV nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB; dok. DVV nr. 19: Syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave” përban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte</p>	<p>Veç të tjera, GVJ konstaton se me rëndësi të madhe në drejtim të zhvillimit të njojurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara në një fushë akademike ose profesionale qëndron dhe përfshirja e personelit akademik me specializime të thelluara në këto drejtime specifike dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit.</p>
	<p>GVJ konstaton se ky program përban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore (dok. DVV nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB).</p>

ligjore e nënligjore.	MSHMB). <i>GVJ rekomandon se në të ardhmen duhet të përfshihen domosdoshmërisht lëndët me zgjedhje në këtë program studimi.</i>								
Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i kurrikulës (dok. DVV nr. 1: Plani mësimor nga vizita në institucion), syllabuseve (dok. DVV nr. 6: Syllabuset) etj. rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh.								
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet pë realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	GVJ konstaton se, nga shqyrtimi i kurrikulës dhe planit mësimor (dok. DVV nr. 57: Kurrikula e studimit MSHMB; dok. DVV nr. 1: Plani mësimor nga vizita në institucion), rezulton e shprehur mjaft qartë koha që lihet në dispozicion të realizimit të temës së diplomës. Semestri IV i dedikohet plotësisht këtij procesi dhe ka 30 kredite në total. Nga intervistat me personelin akademik dhe studentët, por edhe nga dokumentacioni i shqyrta, rezulton se vetë personeli akademik angazhohet plotësisht në këtë proces duke asistuar me përpilimin e platformës së tezës, ndjekjen hap pas hapi të punës eksperimentale të studentit dhe paraqiten përfundimtare pë mbrojtje para komisionit.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"><thead><tr><th></th><th>Përbushet pjesërisht</th><th>Përbushet kryesisht</th><th>Përbushet plotësisht</th></tr></thead><tbody><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></tbody></table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Rezulton se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 6 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Agromjedisit dhe i Ekologjisë; - Departamenti i Akuakultures dhe Peshkimit - Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Pejzazhit - Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve - Departamenti i Prodhimit Shtazor - Departamenti i Shkencave dhe Teknologjive Bimore <p>duke përbushur kështu kriteret dhe detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.</p> <p>Rezulton se DMB si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi përbush plotësisht kriteret ligjore për akreditim. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se DMB ka rregulloren e vet e cila është në përputhje të plotë me rregulloren e FBM dhe me rregulloren e UBT (dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM dhe nr. 7: Rregullore e programit të studimit). Të gjitha këto përkojnë me atë që shprehet në misionin e UBT dhe në statutin e tij.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë	GVJ konstaton se DMB është i organizuar në dy grupe mësimore,

<p>përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>përkatësish Entomologji dhe Fitopatologji dhe ka staf të kualifikuar sipas kriterieve ligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit) rezulton se ata janë tepër të specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi tepër të larta.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve (dok. DVV nr. 19: Syllabuset e lëndëve) rezulton se në këtë programi studimi pjesa më e madhe e lëndëve realizohen nga staf akademik i DBM. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore konstatohet se DMB përbëhet nga 14 anëtarë personel akademik, nga të cilët 9 janë të kategorisë ‘profesor’. Konkrektisht kualifikimet e stafit të këtij departamenti janë: 6 Prof. 3 Prof. As. Dhe 5 Dr.</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Rezulton e dokumentuar qartë se DBM përbush detyrimet ligjore përsa i përket organizimit në gruplendë, strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik ‘mësimor’ apo ‘kërkimor’, etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore (dok. nga vizita në institucion nr. 6: Planifikimi i ngarkesës mësimore 2018-2019) rezulton se personeli akademik i kategorisë ‘Lektor’ që mban dhe gradën shkencore ‘Doktor’ është i angazhuar më së shumti në zhvillimin e praktikave mësimore dhe seancave laboratoriike. Gjatë zhvillimit të këtyre veprimitarive ata asistohen nga personeli ndihmës akademik. DMB ka dhe personel akademik të kategorisë ‘Kërkimorë’ të cilët më së shumti (përveç ngarkesës së detyrueshme në auditor sipas ligjit) janë të angazhuar dhe me analiza ‘shërbimesh për të tretë’.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rezulton se njësia kryesore ka vendosur në rolin e koordinatorit të programit të studimit përgjegjësin e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, i cili mban titullin akademik Prof. Dr.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Gjatë intervistave me presonelin akademik, ata shprehen se koordinatori i programit, që është njëkohësht dhe përgjegjësi i DMB, bën transparente gjatë mbledhjeve periodike të DMB çdo çështje që lidhet me këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 25%; text-align: center; padding: 5px;">Përbushjet pjesërisht</td> <td style="width: 25%; text-align: center; padding: 5px;">Përbushjet kryesisht</td> <td style="width: 25%; text-align: center; padding: 5px;">Përbushjet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se DMB disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit si: kurrikulat (dok. DVV nr. 57: Kurrikulat mësimore MSHMB), planin mësimor (dok. nga vizita në institucion nr.1: <i>Plani mësimor 2018-2018</i> dhe nr. 6: <i>Planifikimi i ngarkesës 2018-2019</i>), syllabuset (dok. DVV nr. 19: <i>Syllabuset e lëndëve</i>), etj.
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i detajuar i kurrikulës, planit mësimor dhe syllabuseve, nuk paraqitet qartë ndarja e elementeve të lëndës (leksion, seminar, laborator). <i>Në shumicën e rasteve rezulton se elementët e veprimtarisë mësimore 'seminar' dhe 'laborator' përfshihen në një kategori të vetme.</i> Diçka e tillë është me rëndësi të madhe veçanërisht në rastin e programeve të tilla të studimit me karakter të theksuar aplikativ të cilët pikën e tyre të fortë kanë pikërisht tematikat e laboratoreve dhe praktikat mësimore dhe profesionale në terren. Nga GVJ konstatahet se ky program studimi nuk përbën lëndë me zgjedhje, kriter që Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, dt. 24.01.2018 e paraqet si të domosdoshëm. Në lidhje me këtë çështje, gjatë intervistave me personelin akademik, ata shprehen se të gjitha lëndët janë të ndara në shumë module specifike dhe çfarëdo informacioni që do të jepej në lëndët me zgjedhje aty në fakt është i përfshirë. Gjithsesi, <i>GVJ rekomandon përmirësimin e syllabuseve duke përfshirë domosdoshmërisht 'lëndë me zgjedhje'</i> . Pasi është një mundësi e rëndësishme për studentët të cilët mund të zgjedhin lëndët në bazë të preferencave apo nevojave të tyre, në bazë të temës që hulumtojnë dhe vizionit të tyre për punësim të caktuar.
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas	GVJ konstaton se në disa raste, një lëndë semestrale është e ndarë në module midis 3 apo 4 anëtarëve të stafit akademik. <i>GVJ sugjeron mundësinë e reduktimit të numrit të pedagogëve për 1 lëndë semestrale pasi në këtë mënyrë mendohet se është më efektive praktikisht dhe teknikisht edhe për studientët (orët në auditor, vlerësimi i vazduhar, vlerësimi final, etj.). Ndoshta mund të shihet mundësia e kalimit të ndonjë moduli apo grupi modulesh si lëndë me zgjedhje.</i> Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit (dok. DVV nr. 57: Kurrikulat mësimore MSHMB) rezulton e shprehur mjaft qartë shpërndarja e krediteve në katër semestra dhe për secilën lëndë apo

sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	veprimitari brenda programit. Ky program rezulton me 30 kredite/seimestër, pra 120 kredite të shtrira në dy vite të plota akademike.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	GVJ konstaton se plani mësimor (dok. nr. 1 gjatë vizitës në institucion: Plani mësimor 2018-2019) paraqet në mënyrë të detajuar shpërndarjen e lëndëve në semestra, shpërndarjen e krediteve, raportin leksion : seminar (<i>ku elementët mësimore 'laborator' dhe 'seminar' përfshihen në të njëjtën kategorji</i>). Nga shqyrtimi i detajuar i planeve mësimore, rezulton se të gjitha lëndët shlyhen me provime gjatë periudhës së sezont.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se 'Rregullorja e programit të studimit MSHMB' (dok. DVV nr. 7: Rregullorja MSHMB, Neni 10 dhe Neni 35), përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuarat.	<i>GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitur në strukturë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, dt. 24.01.2018, por grupi i ekspertëve gjykon që ky udhëzim nuk është kufizues, por lejon zgjerimin e detajuar të elementeve të programeve të studimit në mënyrë që të evidentohet akoma më qartë lidhja dhe rapporti teori : praktikë.</i> <i>Në këtë kontekst, gjykohet se syllabuset duhet të detajohen në të gjitha elementët e programeve të studimit. Dicka e tillë merr vlerë akoma më të madhe duke pasur parasysh që syllabuset janë të paraqitura në website-n e UBT-së dhe kësisoj informacioni është i disponueshëm për cilëndo palë të interesuar.</i> GVJ thekson se detajimi edhe në tematikë i praktikave laboratorike dhe/ose mësimore do të mundësonte dhënien e një informacioni real mbi atë që ofron ky program studimi dhe, rrjedhimisht, do të riste mundësitë e thithjes së studentëve me mesatare më të lartë edhe nga departamente, fakultete apo universitetë të tjera.
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	GVJ konstaton se stafi akademik motivohet për të propozuar ndryshime, përmirësime dhe përditësime të vazhdueshëm në fillim të çdo viti akademik sipas hapësirave dhe afateve të lejuara nga rregullorja e FBM (dok. DVV nr. 52: Procedura për ndryshimin e kurrikulës).
Shkalla e përbushjes së	Përbushjet

standardit	presentuar	kryesish	plotësish
		X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxenit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në dy vite akademike, me 60 kredite në një vit akademik dhe 120 kredite në total (dok. nr. 1 gjatë vizitës në institucion: Plani mësimor 2018-2019). Konstatohet se është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Kriteri 2. Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njojurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se ndër pikat e forta të këtij programi studimi, përvëç kualifikimeve të stafit akademik, janë dhe praktikat laboratorike dhe mësimore jo vetëm në laboratoret e DMB, por edhe në institucionet e sektorit privat (dok. DVV nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale). Në lidhje me sa më lart, nga grupi i vlerësimit të jashtëm konstatohet se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike mjaft të larta, një element mjaft i rëndësishëm ky për t'u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxenit dhe kërkimit shkencor.	Në lidhje me atë çfarë është shprehur në standardin II.3, në mënyrë që i gjithë informacioni që shkon tek publiku i gjerë të jetë sa më i quartë dhe i kompletuar, sugjerohet që në syllabuset e lëndëve të pasqyrohet jo vetëm tematika e leksioneve, por dhe temat e detajuara të laboratorëve dhe/ose praktikave mësimore. Rrjedhimisht është e domosdoshme të paraqitet e detajuar qartë ngarkesa e laboratoreve/praktikave javore dhe semestrale.
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i kurrikulës GVJ konstaton se të gjitha lëndët janë në përputhje me profilin e programit dhe, rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Në lidhje me atë çfarë është shprehur në standardin II.3 duhet të shihet mundësia e përfshirjes domosdoshmërisht të lëndëve me zgjedhje. Duke qenë se ky është një <i>Program Master</i> me kurrikula të harmonizuara me 12 universitete të huaja, konstatohet qartë se në shumë nivele kurrikula është e përputhshme me programe të ngjashme ndërkombëtare.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Gjatë intervistave më personelin akademik dhe me studentët evidentohet qartë që raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve tepër të aftë në këtë fushë. Përsa i përket transferimit të studimeve apo mobiliteteve, GVJ konstaton se kjo është plotësisht e

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	mundur dhe e lehtesar për shkak të përafrimit me diplomën në të njëtin drejtim me atë të 12 universiteteve ndërkombëtare.						
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	GVJ konstaton se syllabuset (dok. DVV Nr. 19: Syllabuset e lëndëve) në tematikë përditësohen vazhdimesht në mënyrë që të jenë në një masë të kënaqshme të përputhshme me trendet ndërkombëtare, por në disa raste literatura e rekomanduar është e vjetër. Nga shqyrtimi i detajuar i syllabuseve GVJ sugjeron që, të paktën literatura shpeshtë, të jetë e 10 viteve të fundit.						
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit garanton përfimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	GVJ konstaton se programi i studimit MSHMB ka përbajtje didaktike, profesionale dhe shkencore shumë formuese dhe garanton përfimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli master (dok. DVV nr. 57: Kurrikula mësimore MSHMB dok.; DVV Nr. 19: Syllabuset e lëndëve).						
Kriteri 8. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ konstaton se evidentohet mjaft qartë në dokumentacion dhe gjatë vizitave që ky program studimi mundëson formimin e specialistëve të fushës plotësisht të aftësuar jo vetëm në zgjidhjen e problematikave të patologjive bimore në vend, rajon e më gjerë, por edhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve (dok. DVV nr. 57: Kurrikula mësimore MSHMB dok.; DVV Nr. 19: Syllabuset e lëndëve).						
Kriteri 9. Për pëmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Rezulton se institucioni ka të dokumentuara marrëveshje me partner të tregut të punës për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, por <i>nuk vërehet dokumentacion që vërteton pjesëmarrjen e përsaqësuesve dhe bashkëpunëtorëve nga tregu i punës në pëmirësimin e kurrikulave të këtij programi studimi.</i>						
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ konstaton se ky program studimi mundëson formimin e specialistëve të fushës të cilët zotërojnë dhe thellimin e duhur teorik dhe praktik për vijimin e studimeve të ciklit të tretë (dok. DVV nr. 57: Kurrikula mësimore MSHMB dok.; DVV Nr. 19: Syllabuset e lëndëve). GVJ konstaton se Projekti i sapo filluar i dedikuar për DMB: HarISA - Harmonization and Innovation in PhD Study Programs for Plant Health in Sustainable Agriculture Project number: 598444-EPP-1-2018-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP (2018-2472/001-001, është një ndihmesë konkrete për përditësimin e syllabuseve në të tre nivelet e studimeve që ofron DMB dhe sidomos në nivelin Master që është pika lidhëse dhe determinative e studimeve bachelor, për studimet e doktoratuës dhe për punësimin e studentëve.						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
		X					

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përbush standartet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit përgarantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit dhe nga vizita në Drejtoren e Burimeve Njerëzore rezulton se DMB përbëhet nga 14 anëtarë të stafit akademik, prej të cilëve 10 janë personel mësimor dhe 4 personel kërkimor (dok. DVV nr. 23: Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë bazë). Në të tilla kushte, rezulton se DMB përbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket personelit akademik. Rezulton e dokumentuar qartë se DMB përbush detyrimet ligjore përsa i përket organizimit në gruplëndë, strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik ‘mësimor’ apo ‘kërkimor’ etj.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik përdrejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga sa vërehet, mosha mesatare e stafit akademik të brendshëm është mbi 55 vjeç dhe në total në personelin akademik mësimor janë vetëm 2 me gradën shkencore ‘doktor’, ndërsa të tjerët i përkasin kategorisë ‘profesor’. 3 doktorantë të tjerë janë të profilit ‘kërkimor’ dhe si rrjedhojë ata kanë normë mësimore të reduktuar. Në të tilla kushte, <i>rekomandohet rekrutimi i stafit të ri në moshë pasi është i domosdoshëm transmetimi i përvojës ndërmjet brezave</i> .
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	GVJ konstaton se DMB është i organizuar në dy grupe mësimore, përkatësisht Entomologji dhe Fitopatologji dhe ka staf të kualifikuar sipas kritereve ligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit) rezulton se ata janë tepër të specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi tepër të larta.
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjtaftueshëm, të duhur e të kualifikuar përi instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimitari të tjera specifike sipas natyrës së programit të	Konstatohet se gjatë dy viteve të studimit në këtë program, studentët realizojnë praktikat në institucione të sektorit privat me të cilat institucioni ka kryer marrëveshje paraprake (dok. DVV nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale).



studimit.	<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mqediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p> <p>Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore (dok. nr. 6 nga vizita në institucion: Planifikimi i ngarkesës mësimore 2018-2019) rezulton se personeli akademik i kategorisë ‘Lektor’ që mban dhe gradën shkencore ‘Doktor’, është i angazhuar më së shumti në zhvillimin e praktikave mësimore dhe seancave laboratorike. Gjatë zhvillimit të këtyre veprimitarive ata asistohen nga personeli ndihmës akademik. Rezulton e evidentuar qartë se personeli ndihmës akademik asiston në realizimin e orëve laboratorike dhe në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mqediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>DMB ka dhe personel akademik të kategorisë ‘Kërkimorë’ të cilët më së shumti (përveç ngarkesës së detyrueshme në auditor sipas ligjit) janë të angazhuar dhe me analiza ‘shërbimësh për të tretë’.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkalla e përbushjes së standardit</th><th>Përbushjet pjetërisht</th><th>Përbushjet kryesisht</th><th>Përbushjet plotësisht</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr> </tbody> </table>			Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushjet pjetërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht				X
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushjet pjetërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht								
			X								

Standardi II.6	Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Gjatë intervistave, personeli akademik u shpreh se për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Gjithsesi, <i>GVJ konstaton se kjo nuk dokumentohet qartë.</i>
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<i>GVJ konstaton se inkurajimi dhe përfshirja e studentëve në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit nuk dokumentohet qartë</i> , por personeli akademik u shpreh se këto konsulenca zhvillohen në mënyrë periodike.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	GVJ konstaton se QKA inkurajon dhe kujton në mënyrë të vazhdueshme studentët e diplomuar për plotësimin e formularit online pas punësimit të tyre, por edhe nga vetë përfaqësues të QKA theksohet se numri i atyre që e plotësojnë këtë formular është shumë i ulët. <i>GVJ konstaton se dhënia nga studentët e diplomuar e propozimeve për përmirësimin e programit të studimit nuk dokumentohet qartë,</i>

	por personeli akademik u shpreh se këto konsulenca zhvillohen në mënyrë periodike.		
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësítë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	GVJ konstaton se institucioni liston një sërë biznesesh me të cilët bashkëpunon për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimore (dok. DVV nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale). Personeli akademik u shpreh që këto praktika përditësohen dhe optimizohen në lidhje dhe me atë se çfarë mund të ofrojnë edhe këto biznese.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi II.7 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit MSHMB ka të përcaktuar qartë prioritetet, fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore, bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në përputhje me statutin e UBT-së (dok. DVV nr. 7: Rregullore e programit të studimit dhe nr. 2: Statuti i UBT-së)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e studimit MSHMB.	Evidentohet mjaft qartë se FBM dhe DMB kanë kombinuar punën e tyre për të bashkërenduar dhe administruar veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e studimit MSHMB (dok. DVV nr. 6: Rregullore e njësisë kryesore).
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Gjatë intervistave studentët shprehen se ata janë nxitur vazhdimisht për aplikimin në kuadër të programit ERASMUS, asistohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik për çdo çështje që ka të bëjë me procesin e mësimdhënies apo me përpilimin e detyrave të kursit, temave të diplomave etj. <i>GVJ konstaton se duhet përfshirje më e madhe në të ardhmen e studentëve në aktivitete kërkimore.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	GVJ konstaton se MSHMB është program i krijuar duke patur në fokus si dhe prioritetet dhe politikat kombëtare ashtu edhe ato rajonale me qëllim ndërkombëtarizimin e programit.
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë, në aspektin finansiar, mbështetet pjesërisht nga institacioni. Veç të

mbështetet finansiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitetet të ndryshme	tjerash DMB realizon analiza në kuadër të çertifikimit të materialit bimor apo diagnostikimit të patologjive bimore (në kuadër të ‘shërbimeve për të tretët’) në dy laboratore reference kombëtare, pjesë e vetë DMB, nga të cilat siguron të ardhura shtesë.						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td></tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
		X					

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombe tarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor DMB ka mbështetur grupet lëndore me projekte kërkimore shkencore dhe ka siguruar bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore. Është për t'u vlerësuar numri i projekteve ‘on going’ në DMB që mundëson kualifikim të mëtejshëm personelit akademik, përmirësim të syllabuseve, praktikave laboratorike etj. (dok DVV nr.103: Projekti HarISA)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkimesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimore shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Evidentohet mjaft qartë se DMB zotëron 2 laboratore reference kombëtare (në Rrashbull dhe në Shkozet) të cilët ofrojnë ekspertizë dhe shërbime ndaj të tretë, e ndihmuar kjo nga fakti që janë të pajusur me një bazë materiale mjaft të mirë dhe kanë personel mëse të kualifikuar për realizimin e analizave specifike. http://pesticidealbania.com/
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferanca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Është e evidentuar se njësia përgjegjëse ka organizuar mjaft aktivitete e konferanca shkencore në përputhje me atë që ofron ky program studimi. Kjo përbën një rëndësi të madhe pasi mundësohet dhe forcohet lidhje me tregun e punës dhe bizneset. bioagbal-conf-2016.net http://pesticidealbania.com/ http://conf1.ubt.inovacion.al/index.php/general-topics/ http://ubt.edu.al/sq/event/konferanca-e-gjashte-e-studenteve-te-universitetit-bujgesor-te-tiranes/

Shkalla e përbushjes së

Përbushjet

Përbushjet

Përbushjet

standardit	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	GVJ pas analizimit të dokumentacioneve kosntaton se UBT në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin (dok. DVV nr. 39: Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies) për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. <i>Megjithatë GVJ konstaton se trajnimet për stafin akademik në vazhdimësi mungojnë, pasi ato kryesish bazohen në projekte.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstaton se në “Strategjinë e zhvillimit të UBT”(dok. DVV nr. 3: Plani Strategjik UBT_Miratuar.pdf) në Kreun e 5; Sigurimi i Cilësisë; ka të pershkruara me detaje aspektin që Sigurimi i cilësisë mbetet kërkesë themelore e UBT-së përritjen e reputacionit brenda e jashtë vendit dhe jepen detaje për mekanizmat që strukturat përgjegjëse të UBT monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. <i>Por, nuk ka pasur vlerësime të jashtme dhe auditime.</i> <i>Pyetësori i përgatitur për vlerësimin e mësimdhënies nga studentët (dok. DVV nr. 40: Pyetësori i studentëve) duhet të përmirësohet edhe me disa pyetje lidhur me opinionet e studentëve se çfarë duhet përmirësuar që programi të përbushë pritshmëritë e tyre (materiali për mësimë, praktika, numri ECT-sve, orari i provimeve, autonomia e studentëve në punë, puna në grup, a kanë nevojë studentet për më shumë praktika, laboratore, punë me kompjuter, eksperiencë me kompani të jashtme etj.).</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Pas kërkimit në website, GVJ ka verifikuar se pyetësori për studentët është i publikuar online në website-in e UBT: http://ubt.edu.al/sq/2019/03/04/pyetesor-per-vleresimin-e-procesit-

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimoreve.	<i>mesimor-nga-studentet/ "Pyetësor për Vlerësimin e Procesit Mësimor nga Studentët". Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, realizohet me anë të pyetësorëve ku një pjesë e tyre janë të lidhura edhe me ankimet.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënien, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në bazë të dokumentit (dok. Msc. nr. 16: Rezultatet e anketimeve – nga komentet e IAL) evidentohet se anketimi realizohet periodikisht dhe personeli akademik pohon se atyre u bëhen me dije rezultatet e anketimit. <i>GVJ konstaton se nuk paraqitet linku se ku mund të gjendet raporti online në ëeb sase të FBM-së.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	GVJ, në bazë të dokumentit (dok. DVV-së nr. 71: Rezultatet e pyetësorit), konstaton se rezultatet e pyetësorëve të studentëve përpunohen dhe paraqiten në formë grafikësh që grupohen sipas rezultateve për të nxjerrë në pah praktikat më të mira. Këto paraqiten në mbledhjet e GMK dhe më pas në mbledhjen e DMB, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

Standardi III.2**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në bazë të takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se personeli akademik i DMB që angazhohet në programin e studimit Master i shkencave në "Mjekësi Bimore" zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, projekteve, praktikave profesionale, orëve të hapura. Gjithashtu, është në përputhje me Rregulloret e Miratuara të UBT, FBM, DMB si dhe Rregulloren e programit të studimit MSHMB (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve _UBT _Final-Version _Dhjetor-2018-1.pdf; dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf; dok. DVV nr. 7: Rregullore mjekesi bimore.pdf).
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit MSHMB në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Disa nga këto metoda janë zhvillimi i mësimit "E-Learning" si një mënyrë elektronike e të mësuarit, është aplikuar në	GVJ pas takimit me stafin akademike dhe studentë konstaon se personeli akademik i programit të studimit MSHMB angazhohet dhe punon për diversitetin dhe nevojat e studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit MSHMB në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Disa nga këto metoda janë zhvillimi i mësimit "E-Learning" si një mënyrë elektronike e të mësuarit, është aplikuar në

<p>përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>MSHMB për dhënien e njojurive, mësimdhënies, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile, etj. <i>Sistemi E-learning për momentin nuk është aktiv për shkak të kostos së pagesës. Gjithashtu duhet të synohet që materialet e shtypura nga disa profesore zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, linke, website, materiale të bashkëngjitura, prezantime power-point, audio, video, teste, forume, animacione, etj.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxenit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ pasi ka konstatuar se mjediset ku zhvillon mësimin MSHMB ofrohet wi-fi në mbështetje të personelit të tij akademik dhe studentëve, në përmirësimin e kompetencave didaktike. Metodat dhe qasjet e mësimit elektronik ndihmojnë stafin akademik dhe kanë krijuar forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të transmetimit të dijeve duke mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të mësimxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njojurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GJV pas analizimit të CV-ve të personelit akademik (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit), konstaton se në përgjithësi personeli akademik i programit të studimit MSHMB posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie në shpjegimin e njojurive dhe koncepteve, dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit siç janë: videot për depërtimin e patogenëve në bimë, pamje mikroskopike dhe të animuara të insekteve dëmtues, animime të zhvillimit të praktikave laboratorike.</p> <p><i>Ndërsa, përsa i përket laboratorëve virtualë studentët kanë deklaruar se nuk kanë shumë njojuri për këtë formë të mësimdhënies.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ ka ardhur në përfundim se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen nga studentët, kjo fillimisht direkt në klasë duke diskutuar me ata në lidhje me elementë të veçantë të paraqitjes së tyre dhe të përmirësimeve eventuale. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies.</p> <p><i>Megjithatë, pyetësori i përgatitur për vlerësimin e mësimdhënies nga studentët duhet të përmirësohet edhe me disa pyetje lidhur me opinionet e studentëve se qfarë duhet përmirësuar në mënyrë që programi të përbushë pritshmëritë e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në bazë të takimit me studentët dhe personelin akademik GVJ konstaton personeli akademike përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Këto paraqiten përmes materialeve audiovizive dhe video projektorit, por edhe në aplikacionet e ndryshme në App (smart phone). Kontrolli i tyre mund të kryhet brenda orës së mësimit realizohet në mënyrë interaktive duke shkëmbyer mendime me studentët, duke i lënë të diskutojnë për një temë të caktuar në grupe 2-3 por edhe më shumë studentë në varësi të problemit të krijuar, duke i lënë të prezantojnë detyrat e kursit para</p>

	klasës dhe duke bërë diskutim në grup për çdo ide të re të paraqitur, por edhe për mënyrën e interpretimit të problemit. Gjithashtu aplikohen edhe vlerësimi me anën e kuizeve si Socrative; (https://b.socrative.com/login/student/) apo Kahoot; (https://create.kahoot.it/register).
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguarar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Pas diskutimeve me studentët, GVJ konstaton se format dhe metodat innovative të ndryshme të mësimdhënies janë tërheqëse dhe më fleksibël për studentët të cilët mund të marrin informacione nga çdo lëndë/modul në përshtatje me kohën e tyre. Këto metoda krijojnë lehtësi pasi studentët mund të shikojnë video dhe prezantimet disa herë derisa ato të kenë kuptuar dhe marrë gjithë materialin si dhe cilësia më e mirë e mësimdhënies dhe studimit.
Shkalla e përbushjes së standardit	<input type="checkbox"/> <input checked="" type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input checked="" type="checkbox"/>

Standardi III.3

Njësité përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në disposicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>GVJ pas vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor në DMB realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. <i>Gjithashtu duhet përmendur se GVJ ka vërejtur se godina kryesore e FBM-së në kampusin e UBT-së, përmomentin e shëtitë në rinovim e sipër dhe kryesisht në këtë godinë studentët ndjekin leksionet dhe punë didaktike laboratorike.</i></p> <p>DMB gjithashtu zotëron “Laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve” në dy godina në Durrës (Shkozet dhe Rrashbull), që kryesisht kryen analiza laboratorike dhe por shërben dhe për kërkim shkencor për temat të studentëve të programit Master i shkencave në “Mjekësi Bimore” (dok. DVV nr. 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në shërbim të programit). GVJ konstaton se edhe godina në Shkozet ka nevojë për rinovim, por në përgjithësi sallat e mësimit dhe laboratorët duhet synuar që në të ardhmen të ngritin standardin.</p> <p>UBT zotëron Akt Higjeno-Sanitar sipas Vendim nr. 1, Proces-Verbal nr. 60, datë 17/04/2014. Departamenti ka auditore, klasa, laboratore dhe zyra në katin e parë dhe të dytë.</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të përisur me logistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Pas kontrollit të ambienteve për mësim, GVJ konstaton se janë të përisura me logistikën e nevojshme për zhvillimin me cilësi të procesit mësimor. Klasat dhe laboratorët mësimore janë të përisur me ndriçim dhe perde errësuese, kompjutera, projektorë, sete entomologjike, sete fitopatologjike, stereomikroskopë, mikroskopë, postera formues, harta me demonstrime të sëmundjeve dhe patogenëve bimorë, çelsa identifikimi për disa insekte, bazë materiale për kryerjen e praktikave

	mësimore.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Pas kontrollit të ambienteve për mësim GVJ konstaton se sallat e leksioneve dhe laboratorëve të DMB në kuadër të FBM por edhe ato të Shkozitet dhe të Rushbullit janë të pajisura me kompjuterë dhe sistem interneti dhe wi-fi për realizmin e procesit mësimor. Gjithashtu, biblioteka universitare ofron sallë studimi dhe kompjuterë për studentët me kapacitet 50 poste. Ka 10 kompjuterë në gjendje të mirë pune. Studentët në këtë ambient mund të studiojnë me materialet e tyre, si dhe mund të punojnë në grup për detyrat e kursit dhe projektet që kanë në programin mësimor.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në disposicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Në bazë të informacioneve të marra nga përgjegjësja e bibliotekës, GVJ konstaton se DMB ka trashëguar nga Instituti i Mbrojtjes së Bimëve një bibliotekë shumë profesionale me libra bazalë që lidhen me fushat kryesore të studimit të DMB; Fitopatologji, Entomologji, Mbrojtja e Integruar, Mbrojtja Kimike, Përdorimi i Agjentëve Biologjike, etj. Biblioteka e LMB posedon të gjithë periodikët e botimeve të buteliveve shkencore të kryera në vite nga specialistët e Institutit të Mbrojtjes së Bimëve. Kjo është një eksperiencë e mirë për studentët dhe specialistët e rinj për të njohur historikun e pranisë së parazitëve bimore në vendin tonë, përdorimin e pesticideve në vite si dhe metodologjitet e kontrollit në mbrojtjen e bimëve. Janë mbi 170 tituj librash të dokumentuar, <i>por një pjesë e tyre janë të vjetër dhe në aneks janë vetëm 6 libra të paraqitur nga pedagogët (dok. DVV nr. 73: Lista e librave të programit MSHMB).</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	GVJ ka vizituar Bibliotekën e UBT-së përfshirë sallën e librit tekniko-shkencor "Vasfi Samimi", kapaciteti 35 poste; studentë të anëtarësuar 862; pedagogë të anëtarësuar 208; staf ndihmës akademik dhe administrativ 76. Frekuentimi më i madhi rrreth 400-500 përdorues në muaj. Salla e librit artistik dhe periodikut: kapaciteti 40 poste; studentë të anëtarësuar 358; pedagogë të anëtarësuar 63; staf ndihmës akademik dhe administrativ 62. Nga informacionet në RVB, frekuentimi më i madhi rrreth 350-540 përdorues. Për më shumë, edhe në Shkozet gjendet një bibliotekë e vogël në disposicion të studentëve. Gjithashtu, Biblioteka ofron informacione online nga burimet elektronike (me abonim ose free nga projekte të ndryshme, aktualisht Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI), që dokumentohet (dok. DVV nr. 74: Biblioteka + plani strategjik). <i>Por disa botime janë të vjetër dhe pedagogët nuk janë të detyruar të dërgojnë kopjet e librave të tyre që batojnë për studentët në bibliotekë. GVJ konstaton se biblioteka duhet të pasurohet me botime të reja.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përaferta me programin e	GVJ pas takimit me stafin akademike dhe studentët ka konstuar se në kuadër të Projektit Erasmus+ "Library Network Support Services" (LNSS), e cila është pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me burime informacioni shumë të pasura gjendet në linkun: https://lnss-albania.libguides.com/ personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të

studimit.	përafërtë me programin e studimit. Derisa, për të përcjellë informacionin kudo dhe kurdo, është krijuar në masën më të madhe katalogu online i Bibliotekës përmes linkut: http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss .
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Pas vizitave të laboratorëve në Kamëz, Shkozet dhe Rrashbull, fermës didaktike, GVJ ka ardhur në përfundim se DMB dhe LMB posedojnë mjedise dhe strukturë të mjaftueshme laboratorike me pajisje bashkëkohore për realizimin e analizave nga ato morfologjike, serologjike (ELISA, DTBIA), imunofluorescenca, ekstraktimi i ADN, Polimerase Chain Reaction (PCR), gel elektroforeza, real-time loop mediated isothermal amplification (RT-LAMP) etj. Të gjitha ambientet laboratorike të LMB frekuentohen nga studentët fillimisht në kuadër të lëndës "Analiza Instrumentale" dhe më pas sipas preferencave individuale ata i bashkëngjiten seancave të ndryshme të punëve si: përgatitja e terreneve ushqyese, inokulimet për kulturën e pastër, procedurës së ekstraktimit të testit ELISA, ekstraktimit me azot të lëngët, ekstraktimeve të ndryshme në biologjinë molekulare me kitet e QIAGEN DNA, etj. si Miniplant extraction, MERICON, CTAB, etc. Procedurës së PCR, gel elektroforezës, etj.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	GVJ konstaton se në kuadër të projektit TEMPUS IPM, Shqipëria dhe Italia kanë udhëhequr platformën digitale I – learning "Second Life", në kuadër të projektit personeli akademik u trajnua për përdorimin e kësaj platforme, që mund të gjenden ne ueb faqen: http://tempus.agrif.bg.ac.rs/learning dhe https://join.secondlife.com/?lang=en-US GVJ vlerëson se pedagogët dhe studentët kanë zhvilluar këtë metodë, edhe pse kjo metodë është shumë tërheqëse dhe interesante për studentët, por pak më e vështirë për pedagogët e vjetër dhe të pa mësuar me metoda të avancuara inovative të mësimdhënies. Për më shumë në bazë të takimeve me stafin akademikë GVJ ka konstatur, se sistemi E-learning për momentin nuk është aktiv për shkak të kostos së pagesës.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar janë të krijuara adresat elektronike @ubt.edu.al, si dhe sistemi i vlerësimit ESSE 3. Gjithashtu brenda serverit të UBT ekziston sistemi "site pedagogë" i cili ka një ndarje strukturore sipas departamenteve dhe mundësi aksesimi për të gjithë pedagogët për të vendosur dhe lexuar informacione vetiakë dhe të dedikuara nga më të ndryshmet.	DMB ka bërë një profil të plotë të saj të cilin e pasuron herë pas here me materiale të reja për departamentin në qeb faqen: https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-simbimeve/rreth-nesh-about-us/home . dhe Informacioni dhe ecuria e MSHMB: https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se

	bimeve/master-shkencor-scientific-master.						
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Nga takimi me studentë, GVJ ka konstaton se studentët kryesisht orientohen nga personeli akademik për zgjedhjen e temave të diplomave. Personeli akademik ndihmon dhe mbështet studentët në zhvillimin e tyre. <i>Megjithëse, GVJ konstaton se nuk kanë fonde specifike për mbështetje financiare për kryerjen e temave (analiza laboratorike, reagente, vizita në fushë etj.).</i>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht		X	
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
	X						

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitet kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Pas analizmit të dokumentacionit (dok. DVV nr.75: Lista e Moduleve ne gjuhen angleze.pdf), GVJ ka konstuar se UBT ka organizuar në nivel institucional me detyrim për MSHMB promovimin e një semestri në gjuhën angleze. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ gjykon se duhet të synohet më shumë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimit; si dhe të motivojnë personelin mësimor në përditësimin e programeve, literaturës dhe trajnimeve për mësimdhënies duke përfshirë më tepër edhe stafin kërkimor-shkencor.</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	<p>GVJ konstaton se FBM dhe DMB janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p> <p><i>GVJ ka konstatuar se DMB organizojnë mësime të hapura nga pedagogë me përvojë, por më pak me pedagogët dhe stafin kërkimor-shkencor më të riny. Duhet domosdoshmërisht të përfshihet më tepër dhe kjo kategori në mënyrë që të shkëmbohen eksperiencia të mësimdhënies në funksion të cilësisë.</i></p>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	<p>Në bazë takimit e stafin akademike GVJ ka konstuar se në kuadër të projektit TEMPUS IPM, janë eksperimentuar 2 metoda të reja inovative të mësimdhënies, "Second life" dhe "ATutor", DMB ka mbështetur këto metoda inovative duke trainuar stafin dhe studentët për njojjen, eksperimentimin dhe zhvillimin e këtyre metodave.</p> <p><i>GVJ konstaton se në bazë të takimit me studentët e viti akademik 2018/19, ata ende nuk janë trainuar për përdorimin e "Second life" dhe "ATutor".</i></p>
Kriteri 4. Personeli akademik	Nga CV e personelit akademik dhe mbështetës (dok. DVV nr. 20: CV e

<p>dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>stafit akademik të programit të studimit) të DMB vërehet një numër i konsiderueshëm i kualifikimeve të tyre në fushat respektive që ata mbulojnë, duke pasur parasysh se pedagoget janë më shumë të angazhuar në auditore dhe laboratore, në të ardhmen rekomandohet që pedagogët të reduktojnë orët për auditore dhe kaboratore në mënyrë që të kanë kohë më shumë për kërkime shkencore.</p> <p>Kualifikimet kryesisht janë realizuar me projekte të ndryshme në kuadër të TAIEX, programeve të MBZHR, projekteve TEMPUS, ASDO, EUPHRESCO, H2020 POnTE dhe XF-ACTORS – projekte të finançuara nga Bashkimi Europian, por më pak nga aplikime individuale përfundimtare ose bashkë-financim nga personeli akademik.</p> <p><i>Në dokumentin me numër 76: Certifikata të trajnimeve të studentëve, të DVV-së, paraqiten gjithsej 5 dokumente, që deklarohet se dëshmojnë kryerjen e trajnimeve të personelit akademik. Në fakt GVJ konstaton se ato janë dokumente të studentëve që kanë kryer trajnime dhe jo të personelit akademik.</i></p> <p>Nga dok. Msc. Nr. 8 – Komente nga IAL, evidentohet se disa anëtarë të personelit akademik kanë kryer kualifikime në përputhje me drejtimin shkencor të tyre, por numri i këtyre kualifikimeve mbetet i pakët.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësítet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ ka konstatuar se trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja është realizuar që gjatë projektit TEMPUS IPM, por kjo ka ndodhur gjatë viteve 2009-2012. Shumica e personelit akademik ka kryer trajnimet e duhura për mësim sa më cilësor. Rrjeti ekzistues i projektit TEMPUS si dhe fitimi i një projekti të ri ERASMUS, është një mundësi shumë e mirë për trajnime.</p> <p>GVJ ka konstatuar se janë implementuar edhe disa projekte tjera për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja sic janë: TEMPUS; CONSUS: “Të lidhim Shkencën dhe Shoqërinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm” dhe LIFE ADA “Mësim gjatë gjithë jetës për bujqësi të qëndrueshme në rajonin Alpet-Danub-Adriatik”, janë zhvilluar trajnime për metodat e reja inovative dhe interaktive didaktike si dhe për përgatitjen dhe paraqitjen e materialeve të mësimdhënies. Në kuadër të projektit është përgatitur edhe manuali „Teaching Resources Handbook“, që mund të gjendet në këtë ueb faqe.</p> <p>http://www.sustainicum.at/files/news/Handbook_English.pdf dhe https://moodle.com/.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga takimi me pedagogë GVJ konstaton se personeli akademike nihmës akademik janë të interesuar për implementimin sa më të suksesshëm të programit të studimit MSHMB, i gjithë personeli akademik është i interesuar dhe angazhuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Disa prej tyre janë trajnuar në Universitete perëndimore, Universitetit BOKU në Vienë, Universitetit të Barit, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik</p>	<p>GVJ pas takimit me personelin akademike dhe analzimit te dokumentacioneve konstaton se në përgjithësi personeli akademik dhe</p>



testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse, drejtuesi i departamentit këto i ka mbështetur dhe sa këto janë raportuar edhe në dekanat me anë të analizës mësimore të DMB-së (dok DVV nr. 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (periodike/vjetore)).								
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në fazë të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënisë dhe kërkimit shkencor	GVJ pas rishikimit të dokumentacionit konstaton se në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, në programin MSHMB janë angazhuar lektorë të ftuar brenda dhe jashtë vendit në fazë të ndryshme të programit: psh. në lëndën e kërkimit shkencorështë ftuar për të dhënë leksione studentëve por edhe stafit akademik drejtori i AKKSHI. Gjithashtu, ka pasur shkëmbime idesh përmësime praktike nga 2 përfaqësuesit e kompanive të mëdha të pesticideve si Syngenta (dok. DVV nr. 77: Përdorim i sigurt dhe Programi i trajtimeve te perimeve nga Syngenta.pdf). Në të dyja rastet interesimi dhe eksperiencia e ofruar janë vlerësuar maksimalisht nga studentët. <i>Mirëpo GVJ konstaton se numri i lektorëve dhe kërkuesve shkencorë të angazhuar për shkëmbim të ideve për kërkim shkencor, ka qenë shumë i pakët.</i>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" data-bbox="584 927 1469 1089"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e FBM, DMB dhe të programit MSHMB (dok. DVV nr: 6&7: Rregulloret e FBM, DMB), janë publike në website e departamentit https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve/?pli=1 dhe janë në dispozicion të studentëve.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përputhje të plotë me Rregulloret e UBT, FBM, DMB (dok. DVV nr: 5, 6&7: Rregulloret e FBM, DMB dhe UBT), dhe atë të programit. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive	Nga takimi me studentët GVJ konstaton se detyrat e kontrollit organizohen në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe




profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njojuritë dhe kompetencat e fituara	vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim. Provimi final organizohet i kombinuar (me shkrim dhe me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësimin të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	GVJ ka rishikuar Rregulloren e programit të studimit MSHMB, dhe ka konstatuar se duke ju referuar Rregulloreve së DMB, FBM, UBT (dok. DVV nr: 5, 6 & 7: Rregulloret e FBM, DMB dhe UBT), është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale: Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazduhar gjatë vitit përfundimtar. Vlerësimi i vazduhar gjatë vitit përfaqëson 40% të vlerësimit total. Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazduhar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimt dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë formën të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ pas takimit me personelin akademike sekretarin e studentëve ka konstatuar se Institucioni posedon sistemin ESSE 3 dhe pikët e vlerësimit gjatë vitit vendosen në sistemin ESSE 3 dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi dhe duhet të konsiderohen nga pedagogu edhe për sezonet e tjera përfundimtar. Gjithashtu rezultatet e provimit vendosen në sistemin elektronik ESSE 3 nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitet përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik GVJ ka konstatuar se testimi përfundimtar i vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në bazë të rregullave të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit MSHMB (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf).
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit	GVJ konstaton se testimi i vlerësimit të njojurive dhe dijeve me shkrim,



<p>i njojurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>zhvillohet në mënyrë anonime me kod dhe UBT ka fletore të dedikuara për të kryer këtë kodim.</p> <p>Forma e vlerësimit në MSHMB është me shkrim dhe me gojë, <i>mirëpo tek pjesa e provimit me gojë kodimi nuk funksionon.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentit (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf), Neni 63, format e kontrollit të dijeve provimet finale në MSHMB organizohen në formën e kombinuar (me shkrim dhe me gojë) kombinuar (me shkrim dhe me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eleminuese. Komentet në vlerësim jepen në momentin e deklarimit të vlerësimit në prani të gjithë studentëve dhe komisionit të pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Në të gjitha rregulloret është e përcaktuar se ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të Universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, e personave të tjera të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorim/kontroll. Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e mëposhtme të identifikimit: librezën e studentit/kartën e studentit/kartën e indentitetit. Nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, por në asnjë rast i celularëve. Pas dhënes së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjera të grupit, apo kursit përkatës.</p>	<p>GVJ vlerëson se njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Në të gjitha rregulloret është e përcaktuar se ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të Universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, e personave të tjera të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorim/kontroll. Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e mëposhtme të identifikimit: librezën e studentit/kartën e studentit/kartën e indentitetit. Nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, por në asnjë rast i celularëve. Pas dhënes së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjera të grupit, apo kursit përkatës.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentit (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf), Neni 61, sistemi i vlerësimit, për vlerësimin e njojurive të studenteve përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. Të gjitha rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkesën përrishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentit (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf), Neni 70, shpallja e rezultateve të provimit, pas shpalljes së rezultateve vendosjes së tyre në sistem, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankirim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentit (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf), Neni 71, ankimimi, komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara</p>



Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve. Pas 12 ditëve (nga data e provimit) sistemi nuk gjeneron më procesverbalin për atë modul.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuar e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton se ky është një Program Master me kurrikula tMaster me kurrikula të harmonizuara me 12 universitete të huaja. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, në kuadër të projektit TEMPUS, u finalizua hartimi dhe zhvillimi i Masterit të përbashkët ndërkombëtar në Mjekësinë e Bimore (IPM). Programi studimit MSHMB garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale të veçanta të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit MSHMB ka zhvilluar aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit në gjuhën shqipe dhe angleze. <i>Nga takimi me studentët GVJ konstaton se vetëm për disa website studentët janë familjarizuar që ofrojnë informacion në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe të pesticideve, por kanë nevojë të informohen më shumë në të ardhmen.</i> Në kuadër të projektit ERASMUS PLUS CBHE pritet që studentët e MSHMB të janë aktorët e parë të "Qendrës virtuale" diagnostikuese dhe pjesë të "HUBs" trajnuese që do të krijohen nga projekti i sapo filluar
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Pas diskutimit me personelin akademike dhe studentet, GVJ konstaton se në përfundim të modulit zakonisht pedagogu i lëndës analizon së bashku me studentët arritjen ose jo të objektivave të modulit si dhe pritshmëritë për rezultatet e dijes. Kjo diskutohet edhe në mbledhjet e GMK si dhe në mbledhjen e departamentit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik GVJ konstaton se personeli akademik në përfundim të çdo lënde/moduli, organizon një bisedë të hapur me studentët duke diskutuar me ta arritjen apo jo të objektivave të modulit si dhe të rezultateve të tij.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar)	GVJ në bazë takimit me personelin akademike konstaton se jashtë strukturës së programit të studimit janë organizuar nga personeli akademik



<p>realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>i brendshëm orë të hapura dhe seminare, si psh: "Loop mediated isothermal amplification: an innovative gene amplification technique for plant diseases".</p> <p>Megjithatë, GVJ konstaton se nuk ka shumë orë të hapura nga profesorë të ftuar dhe në të ardhmen duhet shikuar mundësin e organizmit te oreve të hapura dhe seminare nga profesorë të ftuar mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike dhe praktikat profesionale së bashku me studentët.</p> <p>GVJ ka konstatuar se personeli akademik i Laboratorit të Mbrojtjes së Bimëve, së bashku me studentët e MSHMB, kanë marrë pjesë: "First International External Quality Assessment studies for laboratory performance of molecular and serological diagnosis of <i>Xylella fastidiosa</i> in Olive" in frame of: External Quality Assessment studies for laboratory performance EU-XF- PT-2017- 02: Proficiency testing for the evaluation of molecular and serological diagnosis of <i>Xylella fastidiosa</i>.</p> <p>https://www.xfactorsproject.eu/results-of-the-1st-international-study-for-laboratory-diagnosis-of-xylella-fastidiosa/</p> <p>Performance e punës së personelit akademik dhe të studentëve në këtë Test zotësie është vlerësuar 100% me metodat e avancuara molekulare.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ pas takimit me personelin akademike dhe analizmit te dokumentacionit ka konstauar se në DMB funksionojnë 2 grupe mësimore-kërkimore (GMK) dhe konkretisht grupi i fitopatologjisë dhe dhe ai i entomologjisë, të cilët sistematikisht zhvillojnë diskutime kreative në lidhje me problemet fitosanitare në rajon me Universitetet partnerë: Universiteti i Barit (UNIBA), Universiteti Bujqësor i Athinës, Instituti Mesdhetar i Barit (CIHEAM), etj, dhe vendore QTTB Vlorë (dok. DVV nr. 80: Workshop QTTB Vlorë dhe UBT).</p> <p>Megjithatë, GVJ në të ardhmen rekomanon zgjerimin e GMK-ve sipas mundësive dhe ligjeve/udhëzimeve ekzistuese për fushat tjera të Mbrojtjes së bimëve.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Pas analizmit të CV-ve të personelit akademike (dok. DVV nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit), GVJ konstaton se klima e krijuar në marrëdhëniet profesionale konsiderohet relativisht e mirë për zhvillimin e ideve inovative, si dhe studimeve të avancuara. Kjo duket qartë edhe në pjesëmarrjen e përbashkët (grup autorësh) në konferenca shkencore si dhe publikimet në revista në fushat përkatëse.</p> <p>Megjithatë, GVJ konstaton se stafi kërkimor-shkencor dhe ndihmës akademik duhet të përfshihet më shumë në projekte dhe aktivitete të tjera kërkimore dhe shkencore.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet</p>	<p>Në bazë të takimit me stafin dhe studentët GVJ konstaton se UBT organizon çdo vit Konferencën Studentore dhe studentët shfaqin interesim për pjesëmarrje në Konferencë. Ata zhvillojnë diskutime dhe shkëmbim idesh me stafin akademik. UBT i mbështet finansiarisht këta studentë për realizimin e prezantimeve dhe pjesëmarrje në konferencë pa paguar asnje</p>

financiarisht ato.	taksë, por edhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore si psh DAAD, CEEPUS, etj. http://ubt.edu.al/sq/event/konferenca-e-gjashte-e-studenteve-te-universitetit-bujgesor-te-tiranes/ dhe Projekti: Quality Network Biodiversity and Agriculture on the Balkan Peninsula (BioAgBal). <i>Mirëpo, GVJ konstaton se institucioni nuk ofron mbështetje financiare për studimet të avancuara kërkimore e shkencore për studentët.</i>								
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	GVJ ka konstatuar se institucioni implementon një numër të madh të projekteve ERASMUS, CEEPUS, DAAD, etj. që ofrojnë mobilitete të studentëve në Greqi, Slloveni, Gjermani, Kroaci, etj. është një shembull i mirë si personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #d9e1f2; color: black; padding: 2px;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: #d9e1f2; color: black; padding: 2px;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #d9e1f2; color: black; padding: 2px;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #d9e1f2; color: black; padding: 2px;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="padding: 2px;"></td><td style="padding: 2px;"></td><td style="padding: 2px;"></td><td style="padding: 2px; text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						


Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Pas takimit me përgjegjësin e ZKS, GVJ konstaton se për procesin e diplomimit të studentëve universiteti formon komisionet përkatëse si dhe shpall në mënyrë të dukshme pranë sekretarive përkatëse kriteret e nevojshme për t'u përbushur nga studentët në lidhje me mbrojtjen e diplomës para komisionit, në bazë të Regullores se programit të studimit MSHMB (dok. 14 DVV nr. 7: Rregullore mjekësi bimore). Përgjegjësi i DMB propozon komisionin për provimin e diplomimit dhe e miraton atë tek Dekani i FMB (Dok. Msc. Nr. 9: Komisioni i provimeve – Nga komentet e IAL)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në disposicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës në website-in e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve. Inofrimationet më detale mund të gjenden ne ueb faqe: https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve/master-shkencor-scientific-master!	GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në disposicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës në website-in e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve. Inofrimationet më detale mund të gjenden ne ueb faqe: https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve/master-shkencor-scientific-master!
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të	GVJ konstaton se në studimet MSHMB, studentet nuk ju nënshtrohen provimit final, mirëpo kanë punim diplome në bazë të Regullores se programit të studimit MSHMB (dok. 14 DVV nr. 7: Rregullore mjekësi bimore).



gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	<p>Pas takimit me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se personeli akademik sipas profileve të moduleve që mbulon orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave. Një mundësi shumë e mirë që është ofruar 2-3 vitet e fundit për studentët në studime Mjekësi bimore është kryerja e aktivitetit kërkimor të tezës së masterit në universitet te huaja. Marrëveshjet ERASMUS ICM ofrojnë këtë mundësi me kushtin që teza të mbrohet në UBT. Deri më tanë janë realizuar 4 teza të tilla në universitetet në Gjermani (1), Greqi (2), Kroaci (1) nga të cilat 3 janë prezantuar dhe vlerësuar maksimalisht nga komisioni i MSHMB dhe e katërta do të mbrohet në sezonin e radhës.</p> <p><i>Dokument me numër 85: Formulari i propozimit të temës së studentëve dhe 86: Model teze Erasmus JLU of Giessen, Germany mungon në DVV!</i></p>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Në bazë të takimit me studentët dhe stafin akademik GVJ konstaton se DMB dhe LMB vënë në dispozicion të studentëve të gjitha mjediset laboratorike dhe pajisjet që ata disponojnë, në shërbim të kryerjes së matjeve, analizave, si dhe asistojnë në punën laboratorike, <i>përfshire edhe fermën didaktike, e cila është në distancë të caktuara nga kampusi i UBT-së dhe infrastruktura rrugore nuk është e mirë.</i></p>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Pas takimeve me personelin akademike dhe studentet GVJ konstaton se udhëheqësi i tezës e asiston studentin në përpunimin e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p>Gjithashu, udhëheqësi merr pjesë në prezantimin final dhe asiston në zgjidhjen e pyetjeve eventuale që i bëhen gjatë prezantimit.</p>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentit (dok. DVV nr. 5: Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf), Neni 61, sistemi i vlerësimit, në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Nota minimale e kalueshme është 5 dhe maksimale është 10. Nota del si një mesatare artimetike dhe me mirëkuptim nga komisioni i vlerësimit i ngritur me urdhër të përgjegjësit të DMB.</p> <p>Modeli i vlerësimit tw provimit final për Masterin e shkencave në "Mjekësi bimore" dokumentohet me Msc. nr. 10 – nga komentet e IAL.</p>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për	<p>GVJ konstaton se në bazë të (dok. DVV nr. 15: Urdhéri Nr. 405. Dt.08.09.2017), nga Ministria Arsimit dhe Sprotit, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin (dok. DVV nr. 15: Modeli i diplomës; Dok. Msc. nr. 11: Suplementi i diplomës – nga komentet e IAL).</p>



arsimin.				
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konstaton se në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të kryer dhe suplementi i diplomës (mbajtësi i kualifikimit, kualifikimi, shkalla dhe funksioni tij, përbajtja dhe rezultatet e arritura, certifikimi i suplementit etj.)			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit nga përgjegjësi i DMB në arkivën e departamentit. Ndërsa, fletoret e provimit, detyrat e kursit, projekte, prezantimet, ruhen nga pedagog i lëndës për 6 muaj. Të gjitha të dhënat të tjera në lidhje me ecurinë e studentit disponohen nga sekretari i departamentit dhe sekretaria mësimore.	GVJ ka konstatuar se Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit nga përgjegjësi i DMB në arkivën e departamentit. Ndërsa, fletoret e provimit, detyrat e kursit, projekte, prezantimet, ruhen nga pedagog i lëndës për 6 muaj. Të gjitha të dhënat të tjera në lidhje me ecurinë e studentit disponohen nga sekretari i departamentit dhe sekretaria mësimore.			
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X


Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X
--	---------------	----------------------	---------------------	-------------------------------

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ konstaton se të dhënat e personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ përditësohen çdo vit akademik nga drejtuesit e GMK dhe përgjegjësit DMB nga Përgjegjësi i DMB (dok DVV nr. 23: Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësë kresore dhe njësisë bazë). Pas takimit me stafi dhe përgejgjesin e Departamentit GVJ konstaton se të dhënat e reja rifreskohen nga grapi i GMK dhe përgejgjesi Departamanetit dhe ju dërgohen instancave dhe paralel përditësohen në website e UBT por edhe në "site pedagoge" të DMB. Në këto të dhëna përfshihet angazhimi i personelit akademik në program dhe angazhimi i çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik (dok. DVV nr. 25: Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë të stafit akademik).
Kriteri 2. Institucioni harton dhe	Pas analizimit të dokumenteve GVJ konstaton se institucioni harton



zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë) dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit (Rregulloren e rekrutimit UBT të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT, Nr. 2843 prot, date 31.12.2018).								
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	GVJ ka konstatuar se në UBT ndiqet procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës në Buletinini e Njoftimeve Publike si dhe në websitin e institucionit. GVJ konstaton se të gjitha procedurat janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe është e përvkruar me detaje në rregulloren e rekrutimit dhe të institucionit (Rregulloren e rekrutimit UBT të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT, Nr. 2843 prot, date 31.12.2018).								
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përbajtjen e programit të studimit	GVJ gjithashtu konstaton se Institucioni zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë për rekrutimin e punonjësve akademikë, ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike (Rregulloren e rekrutimit UBT të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT, Nr. 2843 prot, date 31.12.2018).								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrate në mënyrë eficente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrate të personelit në mënyrë profesionalë.	GVJ konstaton se pas vizitave te mjediseve dhe infrastrukture, se institucioni punon vazhdimisht për ofrimin e kushteve dhe mjedisve të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrate të personelit në mënyrë sa më të mirë. GVJ konstaton se personeli për realzimin e detyrate shfrytëzon sallat e leksioneve, laboratoret, fermen didaktike etj. (dok. DVV nr. 42: Lista e laboratoreve kerkimore, tabele permblehese e mjediseve te UBT.pdf dhe 42. Lista e Mjediseve ne funksion te Mesimit te UBT.pdf).
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Kjo realizohet përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme në përputhje me fushat e studimit. Nga analiza e dokumenteve dhe takimin me stafin akademike, GVJ vlerëson se personeli është i përfshirë në projekte dhe veprimitari të

studimit.	ndryshme shkencore, përfshirë mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit dhe riintegrimi i tyre në radhët e personelit akademik. Gjithashtu GVJ konstaton se DMB ka një eksperiençë të mirë në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij. (dok. DVV nr. 43: Kualifikime të stafit akademik).								
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Pas analizimit të dokumenteve, GVJ konstaton se UBT posedon Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (dok. DVV nr. 39: Udhëzues ne nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (1).pdf). <i>Në kuadër të projektit Tempus departamenti ka pasur mundësinë të zhvillojë disa trajnime për metodat inovative të mësimdhënies (I-Learning) si "Second life", por që kanë qenë para shtatë viteve dhe përmomentin I-Learning nuk funksionon, për më shumë personeli akademike janë trajnuar edhe për programin "moodle", etj. (dok. Msc nr. 12: Udhëzues Second Life – nga komentet e IAL).</i>								
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Nga takimi me stafin akademik GVJ konstaton se UBT-ja realizon veprimtarinë kërkimore dhe shkencore përmes angazhimit të stafit akademik me kohë të plotë, <i>por numri i pedagogëve të ftuar jashtë vendit është i kufizuar</i> . Stafi me kohë të plotë përbën pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Personeli akademik që angazhohet në veprimtarinë mësimore dhe shkencore është pjesë e ekipoit që ka hartuar programin mësimor. Bashkangjitur në DVV janë: të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit (dok. DVV nr. 6 nga vizita në institucion); Kontratat individuale me UBT, etj.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mqedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mqediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike GVJ konstaton se UBT zhvillon veprimtarinë e tij në objekte të ndërtuara në periudha kohore të ndryshme bazuar mbi standartet e ndërtimit të periudhave përkatëse dhe janë në rrinovim e sipër të mqediseve mësimore. Për realizimin e procesit mësimor UBT-ja ka vënë në dispozicion të gjitha mqediset e universitetit. Në fillim të çdo semestri hartohet orari mësimor në të cilin detajohen mqediset mësimore se ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, praktikat laboratorike, seminaret, etj. UBT plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme të përcaktuara	Pas vizitës së mqediseve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike GVJ konstaton se UBT zhvillon veprimtarinë e tij në objekte të ndërtuara në periudha kohore të ndryshme bazuar mbi standartet e ndërtimit të periudhave përkatëse dhe janë në rrinovim e sipër të mqediseve mësimore. Për realizimin e procesit mësimor UBT-ja ka vënë në dispozicion të gjitha mqediset e universitetit. Në fillim të çdo semestri hartohet orari mësimor në të cilin detajohen mqediset mësimore se ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, praktikat laboratorike, seminaret, etj. UBT plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme të përcaktuara



	<p>nga standardet shtetërore të cilësisë. DMB ofron mësimdhënien teorike dhe praktike të saj në mjediset e FBM në Tiranë si dhe në 2 godinat laboratorike në Durrës.</p>
	<p><i>Nga inspektimi fizik GVJ konstaton se disa mjedise (me theks të veçantë laboratori në Shkozet) është të vjetruar, edhe pse janë duke u kruer disa renovime, mirëpo në të ardhmen dhe duhet rinovuar dhe përmiresuar standardin e sallave të mësimit dhe laboratorëve.</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Pas vizitës së klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera GVJ konstaton se shumica e mjediseve mësimore në DMB, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve është institucioni unikal në vend përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 9908, datë 24.4.2008 "Për Shërbimin Kombëtar të Mbrojtjes të Bimëve" dhe shërben si laborator kombëtar reference për problematikat fitosanitare dhe si reference me partnerët ndërkombëtare të fushës fitosanitare.</p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnjë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>GVJ pas vizitës së laboratoreve dhe mjedisve tjera konstaton se, UBT posedon disa laboratorë didaktike dhe shkencore që mundësojnë aftësim të studentëve në drejtim të shprehive praktike brenda mjediseve të universitetit. Gjithashtu, UBT posedon një Ekonomi të fuqishme Didaktike që konsiderohet laborator fushor i saj, ku në mënyrë permanente studentët zhvillojnë aftësimin e tyre praktik dhe ku eksperimentohen metodologji të ndryshme.</p> <p><i>Në dokumentet (dok. DVV nr. 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën), janë paraqitura skicat e objekteve, ndërtesa dhe mjedise laboratorike.</i></p>
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>GVJ pas vizitës së laboratoreve dhe mjediseve vlerëson se studentët kanë në dispozicion laboratorin e teknologjisë së informacionit (2 laboratore informatike), të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Për më shum studentë ju ofrohet mundësia edhe një sallë për videkonferanca, që është me rëndësi që studentë të kanë mundësi të ndjekin leksione nga profesoret e vendeve të ndryshme.</p>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zoteron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimitarive të tjera praktike	<p>Nga dokumentet e analizuara, GVJ konstaton se UBT për disa vite ka bashkëpunime me institucione shtetërore dhe subjekte private me të cilat ka nënshkruar marrëveshje të posaçme të bashkëpunimit, për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimitarive të tjera praktike. Krahas marrëveshjeve të UBT, të cilat janë në rang institucional, DMB në vite ka krijuar kontakte individuale me partnerë të ndryshëm shtetërorë dhe privatë, ish studentë që tanë punojnë në institucion shtetëror si; ISUV, MBZHR, AKU, (dok. DVV nr. 32: Marrëveshjet e DMB) etj., me sipërmarrës të kompanive të ndryshme specifike për Mbrojtjen e Bimëve; farmaci bujqësore, serra, fidanishte, etj.</p>



	<p>GVJ konstaton se ekzistojnë 2 dokumente të marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni me të tilla kompani apo biznese (dok. Msc.1 dhe Msc.2 – Marrëveshjet e bashkëpunimit - nga komentet e IAL). Shtimi i të tillë marrëveshjeve me nënshkrim të dyanshëm janë domosdoshmëri për konsolidimin e bashkëpunimit dhe janë tregues serioziteti në këtë angazhim.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Pas vizitës së bibliotekës GVJ konstaton se biblioteka Shkencore "Mentor Përmeti" është në dispozicion të studentëve për informacion, inovatore dhe me cilësi mirë dhe për të mbështetur kërkimin shkencor, të mësuarit dhe mësimdhënien. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura, të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë edhe nga studentët e programit të studimit MSHMB.</p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimitarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Në bazë të vizitës dhe takimit me përgjegjësen e bibliotekës, GVJ vlerëson se Institucioni është i pajisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimitarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Për më shumë GVJ konstaton se në bibliotekë dhe website-t të UBT janë punimet e disertacioneve të DMB të cilat ndodhen të arkivuara në bibliotekë dhe në vitet e fundit edhe online në web:</p> <p>https://drive.google.com/file/d/1FQq6t4TscgfhQBB9zUYb4sPdIYUTZyYU/edit.</p> <p><i>Por, GVJ konstaton se duhet pasuar bibliotekën me botime të reja dhe specifike për mbulimin e të gjitha moduleve të veprimitarisë mësimore të programit të studimit MSHMB.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>GVJ vlerëson se Biblioteka ofron informacione online pa pages për studentet nga projekte të ndryshme, aktualisht janë në implementim projektet Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI)</p> <p>Gjithashtu, GVJ vlerëson se është me rëndësi se në kuadër të Projektit Erasmus+ "Library Network Support Services" (LNSS), që janë pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me informacioni shumë të pasura: https://lnss-</p>

	albania.libguides.com/ , dhe studentë kanë në dispozicion edhe katalogun online të Bibliotekës: http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	GVJ vlerëson se biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike (libra, postera, harta, CD-ROM), që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e studentëve. GVJ vlerëson se institucioni posedon sallën e studimit dhe te kompjuterëve (10 kompjuter) për studentët ka një kapacitet 50 poste.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ pas vizitës së Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti" konstaton se studentët mund të dërgojnë informacion përmes e-mailit (biblioteka@ubt.edu.al), tek i gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik lidhur me titujt e ri në bibliotekë, literaturës në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	GVJ pas takimit me studentët konstaton se ata janë të kënaqur me orarin e bibliotekës, nga e hënë në të premtë 8.00 – 16.00 dhe se posedone vende te mjaftueshme për studentet e interesuar.
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Pas takimit me Përgjegjësin e ZKS, GVJ konstaton se UBT disponon sistem menaxhimi të informacionit të saj nëpërmjet të cilit administron çdo gjë që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Universiteti ka një bashkëpunim me AKP (duke realizuar regjistrimin e studentëve nga ZSS në sistemin e AKP http://qsha.gov.al/akp/ për të vazhduar më pas me pajisjen e tyre me NIM. Gjithashtu UBT ka marrëveshje me RASH https://www.rash.al/sq/ me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin	GVJ konstaton se UBT disponon sisteme të integruar informacioni si universiteti i parë pilot bashkëpunues në projektin e RASH. Ky projekt garanton sisteme të menaxhimit gjithëpërfshire të



<p>dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>informacionit duke mundësuar sigurimin e informacionit strategjik, duke kombinuar aplikacionet kryesore administrative si: të mësuarit dhe studenti, kërkimin, burimet njerëzore, kontabiliteti, etj., me anën e tre moduleve kryesore: Esse 3, UGOV, dhe IRIS.</p>								
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ ka verifikuar se UBT ka faqen e saj zyrtare (www.ubt.edu.al), në të cilën jetet informacion për fakultetet, ciklet dhe programet e studimit që ofron, shkollën e doktoratës, revistën shkencore, librarinë, Statutin dhe Rregulloret e funksionimit të tij, të dhëna statistikore për numrin e studentëve, të dhëna për stafin akademik, njoftime, etj. Aplikacionet Esse 3 janë lehtësish të aksesueshme nga personeli akademik dhe nga studentët.</p> <p>GVJ konstaton se Institucioni ka site për Departamentet dhe pedagogët: (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemenager/). Personeli akademik përgatit dhe vendos informacione dhe dokumente të lidhura me programin mësimor MSHMB, leksione, skripte, video, etj. në https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/magdalena-cara/.</p>								
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi i menaxhimit elektronik mundëson vendosjen e teksteve në word, krijimin e menuve sipas organizimit vetiak të çdo pedagogu, "upload" dhe "download" e materialeve të ndryshme në word, "power point", pdf, video, etj. Studentët kanë mundësi të hyjnë në këto site dhe të "download" materialet gjithashtu kanë mundësinë të bëjnë komente brenda siteve të pedagogut.</p>								
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ vlerëson se informacionet e hedhura nga Departamenti i Mbrotjtes së Bimëve dhe personeli akademik i tij në "site pedagog UBT", "ESSE3", etj. si psh.: Raportet Mësimore e Kërkimore, PyetSORËT, leksionet, vlerësimet gjatë vitit, vlerësimi përfundimtar, etj. janë vizibël në kohë reale, ato janë gjithashtu të aksesueshme nga studentët dhe organet drejtuese dhe titullarët.</p>								
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit (www.ubt.edu.al) dhe në sitin (pedagogë ubt) ka info për personelin akademik, CV akademike, programin e studimit si dhe leksionet, në gjuhën shqipe dhe angleze:</p> <p>https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/magdalena-cara/home/leksione-ne-anglisht.</p>	<p>GVJ vlerëson se informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit (www.ubt.edu.al) dhe në sitin (pedagogë ubt) ka info për personelin akademik, CV akademike, programin e studimit si dhe leksionet, në gjuhën shqipe dhe angleze:</p> <p>https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/magdalena-cara/home/leksione-ne-anglisht.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studenteve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport finanziar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se zyra e financave, departamenti i financave çdo vit harton një raport finanziar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Informacionet e nevojshme DMB i merr nëpërmjet dekanatit dhe Administratorit të UBT dhe FBM (dok. DVV nr. 49: Raporti Financiar i Vtit 2017.pdf).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfitaura dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	GVJ pas analizës së dokumenteve konstaton se plani i financimit të programit të studimit MSHMB përmban dy kollona kryesore: të ardhurat dhe shpenzimet. <i>Në bazë të dokumentit (dok. DVV nr.50: Buxheti DMB) mjetet për investime janë të vogla dhe nuk figurojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pajisjeve laboratorike, kimikateve, reagentëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financier të tij. Raporti finanziar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributete të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	GVJ konstaton se Institucioni kryen auditim të përvitshëm të brendshëm, duke përgatitur një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë (dok. DVV nr. 49: Raporti Financiar i Vtit 2017.pdf).
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij (Dok. Msc. 14: Lidhur me finansat – nga komentet e IAL).	GVJ konstaton se Administrata e UBT në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, dokumenton raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij (Dok. Msc. 14: Lidhur me finansat – nga komentet e IAL).



programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmérinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	GVJ vlerëson se Institucioni se garanton qëndrueshmérinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminë programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, por dhe nga intervistat me Zyrat e Karrierës së Studentëve (ZKS) se aplikohen politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik për këtë program studimi, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto politika dhe procedura janë shprehur mjaft qartë në dok. DVV nr. 2: Statuti UBT dhe në dok. DVV nr. 5: Rregulloren e Studimeve të UBT.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjtë përfundimtare e gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se nga takimet me ZSS dhe studentët, rezulton se të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk vërehen raste të diskriminimit gjinor, racor, fetar etj.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë	GVJ konstaton se i gjithë informacioni në lidhje me këtë çështje është i bërë publik. I gjithë informacioni i nevojshëm mund të gjendet në

<p>kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesësimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësishët të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>website-n e FBM-së, DMB-së, profilet e pedagogëve etj. Konstatohet se kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e MSHMB janë përcaktuar nga dok. DVV nr. 6 Rregullorja e FBM. Konstatohet qartë se QKA realizon në mënyrë periodike këshillim të studentëve në varësi të nevojave të tyre profesionale.</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpresa çdo viti akademik kriteret të veçanta për përgjedhjen e kandidatëve, përt' u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Konstatohet qartë nga dok. nr. 6: Rregullorja e brendshme e DMB dhe nga dok. DVV nr. 7: Rregullorja e programit të studimit MSHMB se kriteret përfshirjen në këtë program studimi janë të paraqitura në mënyrë të detajuar.</p>								
<p>Kriteri 5. Përpresa fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimt të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Rezulton se QKA përgjegjëse përfshirjen në këtë program studimi disponon numra kontakti të personale në të gjitha rrjetet e Shqipërisë, të cilët angazhohen dhe informojnë nxënësit e shkollave të mesme mbi këtë program studimi dhe çdo element tjetër të domosdoshëm (Dok. nr. 17: Raport performance e QKA 2018).</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" data-bbox="588 934 1456 1071"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimt të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatohet se ky informacion është publik dhe paraqitet në dok. DVV nr. 6: Rregulloret e FBM dhe DMB, dok. DVV nr. 7: Rregullores së programit të studimit dhe nëpërmjet dokumenteve të publikuara dhe të përditësuara.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesësimit.</p>	<p>Konstatohet se i gjithë informacioni mbi kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe të barasvlerësimit të studimeve, etj është publik dhe paraqitet në dok. DVV nr. 6: Rregulloret e FBM dhe DMB si dhe në Rregulloren e Studimeve të UBT-së (dok. DVV nr. 5).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në</p>	<p>GVJ konstaton se këto janë elementë që rezultojnë të paraqitura mjaft qartë në Rregulloren e programit të studimit (dok. DVV nr. 7).</p>



programin e studimit.	Konstatohet se ky informacion është publik dhe paraqitet në Rregulloret e FBM dhe DMB (dok. DVV nr. 6) si dhe në Rregulloren së studimeve të UBT-së (dok. DVV nr. 5) .
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Konstatohet se institucioni aplikon forma të ndryshme për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit si postera (dok. DVV nr. 92: Poster Erasmus DMB), fletëpalosje (dok. DVV nr. 91: Fletëpalosje e DMB) me qëllim thithjen e studentëve me mesatare më të lartë. Këto aktivitete pohohen dhe nga intervista me stafin akademik të DMB dhe studentët.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxenit dhe mundësítë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Nga intervistat me studentët u pohua se ata informohen që në fillim të studimeve në lidhje me shumë çështje që kanë lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Gjatë intervistave <i>ata theksojnë se nuk e kanë të qartë nëse në vijim do të ketë ndonjë lëndë me zgjedhje, dhe se do të dëshironin që në program të kishte të tilla lëndë. Prandaj, rekomandohet që, në të ardhmen, që në fillim të vitit akademik, studentët të infomohen nga personeli akademik i DMB për detajet e programit të studimit dhe angazhimet e tyre në procesin mesimor.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Nga intervistat me studentët u pohua se ata janë të informuar mbi përbajtjen e lëndës, ndarjen në module, shpërndarjen e krediteve, personelin akademik përgjegjës për secilin modul, mënyrën e shlyerjes së lëndës etj.</p> <p>GVJ konstaton se DMB ka përgatitur Guiden (dok. DVV nr. 59: Guidë Informuese për MSHMB) ku paraqiten informacione mbi misionin, vizionin dhe modulet, përbajtjen e tyre, stafin akademik, etj.</p> <p><i>GVJ konstaton se një paraqitje e detauar e elementëve të veprimtarisë mësimore (për sa i përket tematikës, ashtu dhe për ngarkesën javore e semestrale të tyre) mungon në syllabus. Kjo paraqitje konsiderohet e domosdoshme jo vetëm për studentët e regjistruar, por edhe për faktin se këto syllabuse janë lehtësish të</i></p>

	aksesueshëm për audiencën e gjerë, dhe rrjedhimisht, një shpjegim detal i tyre do të ndihmonte publikun për një informim më të qartë të asaj se çfarë realisht ofron ky program studimi me karakter të theksuar aplikativ.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitet e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Rezulton se QKA jep informacione të vazhdueshme (dok. DVV nr. 17: Raport performance QKA) në lidhje me mundësitet për punësim dhe orientimin drejt tregut të punës nëpërmjet ftesës që i bëhet studentëve për pjesëmarrje në panairin e karrierës. Por, <i>konstatohet dhe pothohet dhe nga punonjësit e QKA-së se pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete është e ulët.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjërë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë intervistave nga studentët u pohua se ato janë plotësisht të informuar nga institucioni në lidhje me këto çështje dhe asistohen për informim të vazhdueshëm. https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/auth/studente/
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësishët i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Konstatohet se studentët disponojnë llogaritë e tyre elektronike nëpërmjet të cilave mund të marrin të gjitha informacionet e duhura në portalin elektronik. Nga studentët u pohua se ata përdorin website-in dhe profilet individuale të pedagogëve për të marrë informacionet e nevojshme.
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojn informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	GVJ konstaton se platforma ESSE 3 funksionon me efikasitet edhe për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit mësimor të studentëve. https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/auth/studente/
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Gjatë takimit me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës rezultoi se mbahen me korrektesë dhe përpikëri të plotë të gjitha statistikat e nevojshme për këtë program studimi (dok. DVV. nr. 27: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, etj.).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në ZSS dhe sekretarinë mësimore, konstatohet se e gjithë puna për të përbushur të gjithë këto elementë



<p>studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>ishte e realizuar në mënyrë mjaft korrekte dhe tepër të saktë.</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Konstatohet se edhe kjo çështje realizohej me korrektesë të lartë nga ZSS dhe sekretaria mësimore. Të dhënat për ecurinë e studentëve administrosheshin sipas modaliteteve të përcaktuara në (dok. DVV nr. 5: Rregullore e Studimeve UBT; dok. DVV. nr. 9: Rregullore e ZSS).</p> <p>I gjithë informacioni i domosdoshëm mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit pasqyrohet në (dok. DVV nr. 27: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, etj.).</p>								
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigura dhe lehtësish të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga intervistat vihet re se edhe sekretaria mësimore përdor sistemin ESSE 3 për riatjen e të dhënavë, një platformë që, siç u pohua edhe nga intervistat, rezulton tepër efikase dhe e sigurtë në përdorim.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konstaton se Qendra e Karrierës dhe Alumni përgatit raportin (dok. DVV nr. 17: "Raportin e performancës së QKA"), raport që përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik të DMB.</p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm <i>konstaton se numri i përgjithshëm i personave të diplomuar që plotësojnë formularin e punësimit është më pak se 150 individë në nivel institucionit. Nga përfaqësues të QKA, u pohua se individët e diplomuar shfaqin indiferencë të plotësimit të këtij pyetësori.</i></p> <p><i>Në këto kushte GVJ konstaton se është e pamundur të kuptohet në realitet se sa është numri i të punësuarve që të diplomuar në këtë program studimi vit pas viti.</i></p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (dok. DVV nr. 2: Statut i i UBT-së



<p>përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>dhe 5: Rregullore e UBT-së) rezulton se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të IAL-ve në fuqi.</p> <p><i>Nga intervistat me studentët, ata pohojnë se në grupin e tyre nuk kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.</i></p>								
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësish të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në statutin e UBT-së (dok. DVV nr. 2: Statut i i UBT-së dhe 5: Rregullore e UBT-së) garantonohet pjesëmarrja e studentëve në senat dhe konkretisht në masën dhjetë për qind (të numrit të studenteve).</p> <p>Konstatohet se edhe në Rregulloren e FBM-së (dok. DVV nr. 6) parashikohet formimi, organizimi dhe funksionimi i këshillave të studentëve.</p>								
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesës së mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit, konstatohet se sipas Regullores së FBM (dok. nr. 6), në Kreun XII, Vlerësimi i Cilësisë, në Nenin 91, flitet për Rishikimin periodik të programit të studimit, dhe detajohen plotësish elementët e nevojshëm</p> <p><i>Nga intervistat me studentët ata pohojnë se në grupin e tyre nuk kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i procedurës së rishikimit të kurrikulës (dok. DVV nr. 52: Procedura e kurrikulës) rezulton se në këtë proces angazhohen edhe përfaqësues të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p><i>Nga intervistat me studentët ata pohojnë se në grupin e tyre nuk kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre u jepet mundësia e shprehjes mbi çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me procesin mësimor, por edhe me atë të etikës në sjellje dhe komunikim, të ankimit të rezultatit etj. Nga studentët u pohua se gjithmonë kanë pasur reagimin e duhur institucional në rast kur haseshin problematika të caktuara.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							



Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferencia ose aktivitete ndërkombe të fushën e kërkimit shkencor.	GVJ konstaton nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik se pjesëmarrja në konferencia dhe në botime është e kënaqshme (dok. DVV nr. 66 – 90). Këto punime shkencore të cilat rezultojnë në përputhje me fushën specifike të kërkimit shkencor të secilit anëtar të personelit akademik.			
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimt të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	GVJ konstaton se institucioni ka marrëveshje me disa institucione te huaja dhe vendore te arsimt te lartë me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta (dok. DVV nr. 32-35).			
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruanjë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	GVJ konstaton se DMB vazhdimisht inkurajon studentët për pjesëmarrje në konferanca shkencore http://ubt.edu.al/sq/event/konferanca-e-gjashte-e-studenteve-te-universitetit-bujqesor-te-tiranes/ Në RVB theksohet se studentët inkurajohen edhe për botime në revista shkencore (dok DVV nr. 93: Artikull i studentëve).			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombe të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Nga intervistat me stafin GVJ konstaton se institucioni nuk mbështet financiarisht pjesëmarrje në konferanca apo publikime në revista shkencore. Ata shprehen se do të dëshironin shumë që të gjendej ndonjë mundësi nga institucioni për mbështetje financiare, sigurisht pasi punimi shkencor ti ishte nënshtruar një vlerësimi institucional.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Personeli akademik i DMB u shpreh se ata motivojnë dhe mbështesin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. Nga intervistat me studentët ata shprehen se nuk i kanë shumë të qarta këto koncepte. GVJ konstaton se (dok. DVV nr. 96: Artikull nga projekt PKKZH), i cili është një artikull i botuar në një revistë mjaf prestigjioze, në vetvehte nuk konfirmon përfshirjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre nga institucioni për përfshirje në të tillë studime inovative.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Gjatë intervistave studentët u shprehën në mënyrë unanime se të gjithë anëtarët e personelit akademik ofrojnë asistencën e nevojshme dhe vënë në disponicion të studentëve të gjitha mijediset laboratorike që ata disponojnë në shërbim të kryerjes së matjeve, analizave, për punën laboratorike si dhe përpunimin e rezultateve të marra nga eksperimetet i tyre shkencor.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht



			X	
--	--	--	---	--

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstaton se UBT ka në vizionin dhe misionin e tij bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizmat shkencorë, kombëtarë. Kjo reflektohet mjaft qartë në dokumentin ' Strategjia e Kërkimit dhe Shkencor ' (dok. DVV nr. 97:) e cila është hartuar mbi bazën e praktikave më të mira të deritanishme duke reflektuar prioritetet kombëtare dhe Direktivat Europiane të Horizon 2020 të Kërkimit dhe Zhvillimit në sektorët relevantë të UBT-së për të siguruar një fuqizim të punës shkencore në departament por jo vetëm, duke synuar kërkimin e integruar ndër sektorial.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	GVJ mendon se nga informacioni i grumbulluar dhe i shqyrtuar në mënyrë tërësore, ky program studimi krijon mundësi shumë të mira dhe siguron diplomimin e studentëve me aftesi të larta teorike dhe praktike, të cilët janë kandidatë shumë potencialë për vijimin e ciklit të tretë të studimeve në këtë drejtim shkencor.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Personeli akademik i DMB u shpreh se Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. Në RVB theksohet se këtë vit një nga anëtarët e personelit akademik të DMB, është zgjedhur pjesë e Komitetit Shkencor të COST (The European Cooperation in Science and Technology) për të përfaqësuar Shqipërinë si anëtare e re (e plotë) në COST (dok. Msc. nr. 15: Përfaqësuesi i Shqipërisë në COST – nga komentet e IAL). <i>GVJ rekomandon se në të ardhnem duhet të rritet numri i anëtarëve të personelit akademik që përfshihet në të tillë projekte.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Personeli akademik i DMB shprehet se në kuadrin e- projekteve që koordinon DMB ka një rrjet të gjërë kërkuesish si psh. me CIHEAM Bari, Universiteti i Barit, Universitetin e Potece, Universiteti i Katanias, Universiteti Buqësor i Athinës, Universiteti i Novi Sad, Universiteti i Giessen etj. Nga këto punime ata shprehen se ekzistojnë publikime të përbashkëta, gjë që vërtetohet nga (dok. DVV nr. 103: Artikuj me bashkëautorësi të huaj).
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkontëtarë.	GVJ konstaton se numri i mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS për studentët është i lartë. Studentët u shprehën se ata janë të inkurjuar vazhdimisht për aplikime të tillë.
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkontëtar, fton	Në lidhje me këtë çështje, personeli akademik i DMB u shpreh ka pasur




për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënje, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	pjesëmarrje të larta nga personel akademik apo studentë të huaj.			
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërish	Përbushet kryesish	Përbushet plotësisht X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësish të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Rezulton se në institucion funksionon me efektivitet të lartë ZSS dhe sekretaria mësimore. Konstatohet se këto struktura realizojnë me korrektesë dhe përkushtim të lartë detyrat e tyre në drejtim të informimit të studentëve etj.</p> <p>Edhe nga studentët u pohua njëzëri që sekretaria mësimore është në shërbim të plotë e me përkushtim të lartë.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Konstatohet se në institucion funksionon dhe QKA, e cila, siç pohohet nga studentët, informon mbi mundësitë për punësim apo zhvillimin e praktikave profesionale në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Veç të tjerash, gjatë intervistave theksohet se kjo qendër shërben për të informuar aplikantët për programet e ofruara. Studentët marrin ndihmën e duhur nga Qendra e Karrierës & Alumni (QKA) e cila mbështet integrimin e studentëve në universitet sipas programit të studimit.</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucion e tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Konstatohet se Zyra/njësia për këshillimin e karrierës (QKA) është funksionale dhe realizon mjaft aktivitete informuese.</p> <p>Por, siç pohohet dhe gjatë intervistave dhe siç konstatohet edhe nga (<i>dok. DVV nr. 17: Raport performanca e QKA 2018</i>), në shumë raste numri i studentëve pjesëmarrës në aktivitete apo që drejtohen për këshillim është mjaft i ulët.</p>
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e	<p>Rezulton se QKA aplikon një formular që plotësohet on-line për individët e diplomuar në programet e studimit që ofron institucion, me qëllim gjurmimin e tyre për sa i përket të dhënavë mbi punësimin.</p> <p>Konstatohet se numri i personave që e plotësojnë këtë formular është</p>



punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	<i>shumë i ulët</i> , pavarësisht se nga përfaqësues të QKA-së u deklarua se kjo qendër insiston në mënyrë të vazhdueshme duke bërë thirrje të vazhdueshme nëpërmjet e-mailit.			
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X
--	---------------	----------------------	---------------------	-------------------------------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ pas analizës së dokumentacione dhe rregulloreve përkatëse (dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf; Rregullorja DMB) konstaton se këto rregullore janë të përgatitura në bazë të LAL (L. 80/2015). Në bazë të Rregullores të FBM-së Neni 89, FBM harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. FBM ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimit të mësimore dhe kërkimore shkencore. Gjithashtu standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga FBM, në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR. Në bazë të Nenit 90, të Rregullores së FBM-së shpjegohet se Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ pas analizimit të dokumentacionit konstaton se posedon planin strategjik të zhvillimit “Strategjinë e zhvillimit të UBT” (dok. DVV nr. 3: Plani Strategjik UBT_Miratuar.pdf) ka të përshkruara me detaje aspektin që Sigurimi i cilësisë. Konsiderata të veçanta kushtohen zhvillimit të modeleve të vlerësimit gjatë zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë. Ky aktivitet përfshin: Vetë-analiza, Treguesit e cilësisë, Vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve, Vlerësimin e studentëve, Vlerësimin e programeve mësimore, Vlerësimin e pjesmarrjes në veprimtarinë kërkimore, Vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve nacionale, rajonale dhe më gjerë, Pjesëmarrjen në zgjidhjen



	e problemeve të komunitetit rural. FMB në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit MSHMB (dok. Msc. Nr. 16: Rezultatet e anketimeve – nga komentet e IAL). Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësítë për sigurimin e brendshëm të cilësisë diskutohen në GMK dhe ne mbledhjen e radhës në DMB si dhe në analizat e punës mësimore dhe kërkimore në Departament dhe ne FBM.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	GVJ pas analizës së dokumentacioneve dhe rregulloreve përkatëse (dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf), konstaton se në bazë të Rregullores të FBM-së Neni 89, FBM harton standartet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR. Gjithashtu, raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësítë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në bazë të Rregullores së përmendur më sipër, Neni 90 shpjegon se sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ofrojnë i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike nga ASCAL. GVJ ka verifikuar dokumentin dhe konstaton se UBT ka kryer akreditimin Institucional sipas shkresës të ASCAL Nr.154 prot. datë 12.05.2017 dhe Vendimit të BA Nr.11, datë 07.04.2017 për: "Akreditimin e Parë të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës".			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	GVJ konstaton se Institucioni ka të hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Për këtë arsyе pranë Degës së Mësimit, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional është themeluar Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë dhe roli i saj është Evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin si dhe evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies në funksion të përmirësimit të tij duke përfshi të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. UBT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në UBT, pranë Degës së Mësimit, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë. Fokusi i veprimtarisë së kësaj zyre është: Evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin si dhe evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies në funksion të përmirësimit të tij. GVJ konstaton se në (dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf), kreu XII Vlerësimi i cilësisë janë të paraqitura informacionet përkatëse për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.			
Shkalla e përbushjes së	Nuk	Përbushjet	Përbushjet	Përbushjet



standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxenit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrënjësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Në Rregulloren e FBM (dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf), Neni 92 parashikohet “Rishikimi periodik i programit të studimit”. Fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i fakultetit aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces. Gjatë rishikimit vëmendje i kushtohet: rishikimit të shpërndarjes së krediteve për modulin apo grup - modulet përkatëse; rishikimit të programeve mësimore të moduleve të veçanta; rishikimit të elementeve përbërës të moduleve dhe ndarjen e kredive ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë etj); rishikimi i rregullores së programit të studimit; rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës; rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës; rishikimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik; rishikimi i procedurave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit; rishikim i opinioneve/feedback-ut të marrë nga studentët.</p> <p><i>Megjithatë, përsa i përket literaturës dhe moduleve GVJ rekomandon se ato duhet të përditësohen më shpeshë duke pasur parasysh zhvillimet e fundit në kërkime shkencore në fushën e mbrojtjes së bimëve.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>GVJ pas analzimit të programit studimor ka konstataur se programi studimore MSHMB është krijuar nga projektı TEMPUS, ku vetë konsorciumi dhe komiteti monitorues i projektit kanë në objektin e tyre mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit.</p> <p>Për ndjekjen ndërkontaktore UBT ka emëruar një person kontakti dhe ndjekjen e brendshme e bën koordinatori i programit të studimit (dok. Msc. nr. 17: Emërimi i anëtarit në komitetin monitorues të programit – nga komentet e IAL).</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	<p>GVJ pas takimeve me stafin akademik dhe analizimit të dokumentacioneve konstaton se Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në (dok. DVV nr. 6: Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf), kreu XII, Neni 91, shpjegohet se Institucioni rishikon periodikisht programin e studimit. ZSS dhe zëvendësdekani kontrollojnë në vazhdimësi ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë në zhvillimin e mësimit, të cilat bëhen objekt në procesin e</p>



	rishikimit. Gjithashtu, GVJ në bazë të dokumentit (dok. DVV. nr. 12&13: Rregullore DZHKKVI & DITNJ Final V.2017.pdf) konstaon se në Rregulloren e Monitorimit të Kurrikulës Në Kreun I, Neni 1 dhe 3: Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ), janë themeluar dhe funksionojnë bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë si edhe Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.								
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njoitura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Pas takimit me përfaqësuesit e ZCSVI, GVJ konstatoj se "Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional" (ZSCVI) në bashkërendim dhe nën drejtimin e strukturave drejtuese të UBT ka përgatitur udhëzime dhe Manualin për sigurimin e cilësisë (dok. DVV nr. 8: Manuali i cilësisë) në Universitet në mbështetje të procesit të vlerësimit programor dhe institucional, sipas formave standarde për sondazhet studentore, dhe të stafit.</p> <p>FBM në vazhdimësi kontrollon ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë në zhvillimin e mësimit, të cilat bëhen objekt në provesin e rishikimit. ZSCVI inspekton raportet e vlerësimit të përgatitura nga njësítë dhe kur gjen mos respektim të standardeve të përshkruara në Manual për sigurimin e cilësisë në Universitet ti sugjerojë njësive korrektimin e tyre. Gjithashtu rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njoitura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit</p>								
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	GVJ në bazë të dokumenteve të analizuara (dok. DVV nr. 37: Raporte vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë; DVV nr. 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike); DVV nr. 97: Strategjia kërkimit shkencor), konstaton se raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë pjesë e Raporteve Vjetore të analizës mësimore dhe kërkimore të UBT, FBM, DMB. Në këto Raporte janë përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e	Pas takimit me përfaqësuesit e zyrës së ZCSVI, GVJ konstaton se Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional (ZSCVI), kujdeset që dokumentacioni që prodhojnë fakultetet të përputhet me standaret e kombëtare të cilësisë sipas ciklevë të studimit, merr pjesë në përgatitjen e Guidës në nivel Universiteti, programon kalendarin e procesit të vetëvlerësimit në nivel universiteti dhe ndjek realizimin e tij.



<p>përfshin këtë informacion në vjetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vjetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Gjithashtu, bashkëpunon me Dekanët e fakulteteve për realizimin e vjetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore, harton draftin tip të kërkesave dhe drejtimeve të realizimit të vlerësimit institucional në UBT në konsultim dhe në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve, koordinon bashkëveprimin e strukturave të vlerësimit institucional të fakulteteve, mban lidhje të rregullta institucionale me Agjencinë Kombëtare të Akreditimit të Arsimit të Lartë pranë MASR.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ZSCVI në bashkërendim dhe nën drejtimin e strukturave drejtuese të UBT ka përgatitur udhëzime në mbështetje të procesit të vlerësimit programor dhe institucional. ZSCVI për kryerjen e vlerësimit me formatet standarde për sondazhet studentore, dhe të stafit, Manualin për sigurimin e cilësisë në Universitet i cili është i miratuar nga struktura vendimmarrëse (dok. DVV nr. 8: Manuali i cilësisë).</p> <p>ZSCVI inspekton raportet e vlerësimit të përgatitura nga FBM pjesë e analizës mësimore dhe kërkimore dhe kur gjen mos respektim të standardeve të përshkruara në Manual për sigurimin e cilësisë në Universitet sugeron korrektimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrate të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ pas analizimit të dokumenteve ka konstatuar se Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrate të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime. Institucioni zhvillon një sistem eficient në lidhje me: Monitorimin, menaxhimin dhe politikën e vendim marres, Sigurimin e autonomisë së punës së pedagogëve dhe pozicionin jo diskriminues të studentëve, Internacionalizimin e edukimit të arsimit të lartë, Monitorimin e ecurisë së te diplomuarve dhe programet e postdiplomimit (dok. DVV nr.17: Raport Performanca e QKA_2018_Gjurmimi i studenteve.pdf). Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë këtu përfshihet edhe programi MSHMB (dok. DVV nr. 17: Studimi (periodik për tregun e punës), pas daljes së studentëve).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p>	<p><i>Nga takimi me përfaqësues të QKA-së, pranë FBM, GVJ konstaton se numri i studentëve të diplomuar që i përgjigjen pyetësorëve është shumë i pakët, dhe kësijoj është i vështirë të kuptohet shkalla e punësimit të tyre.</i></p> <p>Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë në përputhje me statutin e UBT (dok. DVV nr.2: Statuti UBT_Miratuar_2018.pdf). Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të cilat përgatiten nga Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, FBM organizon</p>




institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë përvlerësimin e dijeve e kompetencave të përfshirura nga ky program	pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies përlendët e çdo programi studimi. Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese përvlerësimin e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë, përfshirë edhe programin MSHMB.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center; background-color: #d3d3d3;">Nuk përbushet</th> <th style="text-align: center; background-color: #d3d3d3;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="text-align: center; background-color: #d3d3d3;">Përbushet kryesisht</th> <th style="text-align: center; background-color: #d3d3d3;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;"></td><td style="text-align: center;"></td><td style="text-align: center;"></td><td style="text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara përsigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se FBM ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Standardet përsigurimin e cilësisë hartohen nga FBM, në përpjekje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR. Procesi i vlerësimit realizohet me përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Aktorët e jashtëm në programin e studimit MSHMB janë të gjithë partneret e projektit TEMPUS që sipas marrëveshjes së nënshkruar vazhdojnë monitorimin e programit në disa aspekte themelore të qëndrueshmërisë dhe cilësisë së tij.</p> <p>Mirëpo GVJ konstaton se nuk janë të përfshirë mjaftueshëm përpërditësimin e programit edhe aktorët e tjera të jashtëm, kompani, shoqata, etj. Kjo konsiderohet si mjaft e rëndësishme përsigurimin e përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete përnjësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>FBM, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi ku përfshihet edhe MSHMB. Vlerësimi i cilësisë së institucionit, kurrikulës, procesit mësimor, pedagogëve, studentëve, të kontrollohet në mënyrë periodike dhe më pas duke marrë masat e nevojshme përmirësim. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë përsigurimin e brendshëm të cilësisë së institacioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe	<p>GVJ konstaton se në përpjekje me Rregulloren e FBM (dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM.pdf), sigurimi i brendshëm i cilësisë, securia e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit MSHMB ndiqet nga DMB dhe FBM nga personeli akademik, ndihmës</p>




<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në këtë proces vlerësimi.</p> <p><i>GVJ nuk mund të konstatojë se garantohet përfshirja e stafit ndihmës akademik në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shbangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me Rregulloren e FBM (dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM.pdf), departamenti MB është përgjegjëse për krijimin dhe ofrimin e programeve në përputhje me rregullat që garantojnë cilësinë e detyrueshme. Përgjegjësi i Departamentit mbikqyr të gjithë aktorët e brendshëm për të përbushur standartet e cilësisë nën drejtimin e Dekanatit në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, Komisionin e Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit dhe Senatin.</p> <p><i>GVJ konstaton se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shbang diskriminimet apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të jalin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>GVJ ka konstatuar se DMB në kuadrin e MSHMB që në kuadër të projektit TEMPUS (dok. DVV nr. 103: Tempus-lista e partnerëve) ka krijuar një rrjet të qëndrueshëm me partnerë të huaj dhe vendas që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të jalin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Planin strategjik zhvillimor të UBT-së 2016-2025 (dok. DVV nr. 4: Plan strategjia e zhvillimit te UBT, 2016-2025.pdf), janë të pëershruara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucionin gjatë gjithë kësaj periudhe. Veprimtaritë që janë zhvilluar në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MASHMB janë transparente janë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë takimeve me asamblenë akademike dhe me studentët. Ato publikohen në website.</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UBT përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit MSHMB janë diskutuar në GMK dhe më pas në departament, diskutimet kanë respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>GVJ konstaton se nuk svarohet se ku janë të publikuara këto rezultata.</i></p>								
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit në rastet kur ka problematika shoqërohen me një plan masash dhe synon përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Këto programe të masave janë të paraqitura në dokumentin përkatës (dok. DVV nr. 52: Procedura për ndryshimin e kurrikulës).</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Për këtë UBT, FBM në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni organizon aktivitete periodike përfshirë mbledhjet e hapura të asamblesë të FBM me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						
<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë
Master i Shkencave “Mjekësi Bimore” të Institucionit të Arsimit të
Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi Master Shkencor në Mjekësi bimore është program studimi me kurrikula të harmonizuara me 12 universitete ndërkombëtare i përgatitur në kuadër të projektit Tempus IPM;
2. Numër i konsiderueshëm i projekteve që ju jep mundësi studentëve dhe stafit akademik për të kryer këmbim të eksperiencës dhe hulumtime jashtë vendit;
3. Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve është institucioni unikal në vend përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 9908, datë 24.4.2008 “Për Shërbimin Kombëtar të Mbrojtjes të Bimëve” dhe shërben si laborator kombëtar reference për problematikat fitosanitare dhe si reference me partnerët ndërkombëtare të fushës fitosanitare;
4. Projektet Erasmus plus ICM që mbështesin mobilitetet e studentëve dhe pedagogëve;
5. Projekti i sapo filluar i dedikuar për DMB: HarISA - Harmonization and Innovation in PhD Study Programs for Plant Health in Sustainable Agriculture Project number: 598444-EPP-1-2018-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP (2018-2472/001-001);
6. Laboratore të pajisura për zhvillimin e teknikave diagnostikuese bashkëkohore deri në nivel molekular në disa prej fushave të mjekësisë bimore;

Pika të dobëta

1. Mungesa e ‘lëndëve me zgjedhje’ në programin studimor;
2. Në organizimin formal të Planit të studimit, por dhe në syllabuse, sasia e orëve në auditor për secilën veprimitari mësimore (lëndë dhe module) ndahet vetëm në Leksione dhe Seminare, dhe jo edhe në Ushtrime, Laboratore, Praktika, Punë Kursi, etj., si ato kryhen në të vërtetë;
3. Mungon ndërthurja e brezave të personelit akademik si në aspektin e moshës dhe të kualifikimit, në funksion të uljes së ngarkesës mësimore dhe përcjelljes së përvojës akademike.
4. Mungesa e financimeve për zhvillimin e tezave të studentëve dhe për blerjen e reagentëve të domosdoshëm për analiza të thelluara diagnostikuese;
5. Numër i vogël i pedagogëve të huaj, të cilët mbajnë leksione inovative përfshirë kërkimet shkencore më të reja;

Rekomandime

1. Duhet domosdoshmërisht të përfshihen edhe ‘lëndët me zgjedhje’ në programin studimor;
2. Në Planin mësimor duhet të dalin qartë, Leksionet, Seminaret, Ushtrimet, Laboratoret, Praktikat dhe Punë Kursit, përkatësisht sipas lëndëve, madje të ndarë edhe sipas semestrave (I & II), e cila do të ndihmonë për të njojur më mirë brendinë e vetë Programit si nga studentët që ndjekin Programin dhe të interesuar të tjerë.



3. Punësimi i stafit akademik me moshë të re, pasi kjo është në dobi të uljes së ngarkesës mësimore dhe transmetimit të përvjoes ndërmjet brezave; këtu kanë rëndësi edhe përpjekjet për zhbllokimin e kryerjes së doktoratave në institucion;
4. Infrastruktura në laboratorin e Shkozitet duhet të rinovohet në të ardhmen, pasi është e vjetruar.
5. Duhet të rishikohet pyetësori i studentëve, pasi është i mangët dhe nuk përfshin të gjitha aktivitetet e mësimdhënësve dhe realizimin e programit;
6. Literatura e paraqitur në syllabuse dhe në bibliotekë duhet te përditësohet, duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta në shkencë në përgjithësi me theks të veçantë në Mbrojtje të bimëve; Institucioni nuk duhet të reshtë përpjekjet për të zgjeruar hapësirat e Bibliotekës;
7. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe prurja e pedagogeve nga jashtë për ligjërata inovative dhe kërkime shkencore më të reja;
8. Gjetja e mekanizmave institucionalë të tillë që nxitin dhe motivojnë stafin mësimor dhe atë ndihmës lidhur me praktikat më të mira, dhe performancën akademike dhe shkencore më të lartë që ata ofrojnë. Gjithashtu, duhet të përfshihet personeli kërkimor-mësimor në përditësimin e programeve dhe në auditor me cikle leksionesh në mënyrë që të transmetohen eksperiençat profesionale ndër breza midis stafit akademik;
9. Lidhja më e fuqishme me sektorin privat, pasi ata nuk janë të përfshirë direkt në përgatitjen e kurrikulave dhe analizat e tregut për punësim të studentëve;
10. Përthithja e studentëve sa më cilësorë;
11. Bashkëpunime të vazhdueshme midis anëtarëve të stafit akademik për të zhvilluar punime dhe publikime në nivel më të lartë;
12. Është e rëndësishme të përfshihet stafi administrativ në Sekretarinë e studentëve, Qendrën e karrierës, Vlerësimin e brendshëm të cilësisë etj. Përfshirja e stafit akademik në të tilla pozicione ndikon në cilësinë e mësimdhënies, pasi pedagogët duhet të kenë kohë më shumë kohë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
13. Këshillohen gjithmonë përpjekje për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies (auditore, laboratori, mjediset për stafin) dhe pajisje me bazë materiale didaktike sa më bashkëkohore;
14. Institucioni nuk duhet të rreshtë përpjekjet për të shëndoshur të ardhurat financiare në dobi të zhvillimit cilësor të mësimit dhe të kërkimit, përfshirë këtu edhe pagesë më të mirë të stafit akademik dhe ndihmës;

**Conclusions on the Evaluation of the Master of Science Study Program
in "Plant Medicine" Higher Education Institution "Agricultural
University of Tirana"**

Strength and affirmations:

1. The study program 'Master of Science' in "Plant Medicine" is a program with of harmonized curricula with 12 international universities prepared under the Tempus IPM project;
2. Significant number of projects that enable students and academic staff to exchange experience and research abroad;
3. The Plant Protection Laboratory at the Plant Protection Department is the only institution in the country responsible for implementing the Law no. 9908, dated 24.04.2008 "On the National Plant Protection Service" and serves as a national reference laboratory for phytosanitary issues and as a reference to international partners in the field of phytosanitary control;
4. Erasmus plus ICM projects that support student and academic staff mobilities;
5. The newly started project dedicated to the Plant Protection Department HarISA - Harmonization and Innovation in PhD Study Programs for Plant Health in Sustainable Agriculture Project number: 598444-EPP-1-2018-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP (2018-2472/001-001);
6. Laboratories equipped for the development of modern diagnostic techniques up to the molecular level in some fields of plant medicine;

Weaknesses:


1. Lack of 'elective disciplines' in this study program;
2. In the formal organization of the study Plan, but also in the syllabuses, the amount of hours in auditor for each teaching activity (subjects and modules) is divided only into Lectures and Seminars, and not even in Exercises, Laboratories, Practices, Course Works etc., as actually performed;
3. Average age of the academic staff, as well as teaching loads, are relatively high; the lack of new staff (assistants) in the responsible Unit makes it difficult to transmit experience among generations;
4. Lack of funding for the development of student theses and the purchase of the necessary reagents for in-depth diagnostic analysis;
5. A small number of foreign professors, who present innovative lectures including newer scientific research;

Recommendations:

1. It is necessary to include 'elective disciplines' in the study program;
2. In the formal organization of the Curriculum of the study program on the UBT website, it should be clearly shown the category of each teaching activity (lectures, seminars, exercises, labs, practice etc.), as well as all relevant elements; it would help to better understand the content of the Program itself, by students and other interested people.



3. The Unit should make efforts to renew the teaching structure, increasing and refreshing it with young teaching staff, in order to reduce the teaching load and transmit the experience among generations; increase efforts to unblock doctoral degrees in the institution;
4. Infrastructure in the Shkozet laboratory should be renewed in the future as it is outdated.
5. The student questionnaire should be revised, as it is incomplete and does not include all the activities of the teachers and the implementation of the program;
6. The literature presented in the syllabuses and in the library should be updated, taking into account rapid developments in science in general, with particular emphasis on Plant Protection; The institution should not cease efforts to expand the library's space;
7. Strengthening of cooperation and teaching from foreign lecturers for innovative lectures and newer scientific research;
8. Finding of such institutional mechanisms that encourage and motivate the teaching staff and assistants in relation to best practices, and the highest academic and scientific performance they offer. Also, research - teaching staff should be included in the program update and in the auditorium with lectures cycles in order to transmit professional experiences among generations between academic staff;
9. Stronger relationship with the private sector, as they are not directly involved in curricula preparation and market analysis for student employment;
10. The absorption of the best quality students;
11. Continuous co-operation between academic staff members to develop papers and publications at the highest level;
12. It is important to include administrative staff at the Student Secretariat, Career Center, Internal Quality Assessment, etc. Including academic staff in such positions affects the quality of teaching as pedagogues need to have more time for teaching and research.
13. It is always advised to improve the teaching conditions (auditoriums, labs, staff premises) and equipment with the most modern didactic materials;
14. The responsible institution and ministry must always continue their efforts to increase the financial income for the quality teaching and research, including better payment of the staff.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesish	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Valbona Sota

2. Prof. Asoc. Arben Mehmeti